



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në Bashkinë Memaliaj**

# **RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

**Mbi Auditimin Financiar të ushtruar në**

**Bashkinë Memaliaj**

**Tiranë, shtator 2025**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Faqe</b>
	Legjenda dhe shkurtime	3
<b>I</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>4-9</b>
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	4
2.	Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	5-7
3.	Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimit	7-9
<b>II</b>	<b>HYRJA</b>	<b>9-13</b>
1.	Objektivat dhe qëllimi i auditimit	9
2.	Identifikimi i çështjes	9-10
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	10
4.	Përgjegjësitë e audituesve	10-11
5.	Kriteret e vlerësimit	11
6.	Standardet e auditimit	12
7.	Metoda e auditimit	12-13
8.	Dokumentimi i auditimit	13
<b>III</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT</b>	<b>13-54</b>
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin Bashkia Memaliaj	13-14
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	14-54
2.1	Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm	14-22
2.2	Auditimi i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore	23-45
2.3	Verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm	45-54
<b>IV</b>	<b>REKOMANDIME</b>	<b>54-62</b>

## Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
NJA	Njësi Administrative
SHA	Shoqëri Anonime
NJP	Njësia e Prokurimit
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

## **I. PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE**

### **1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit në Bashkinë Memaliaj.**

#### **a. Përshkrim i shkurtër i institucionit:**

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 469/1 prot., datë 25.04.2025, Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KLSH) auditoi **Bashkinë Memaliaj**, për periudhën 01.01.2024, deri më datën 31.12.2024. Për vitin 2024 realizimi i shpenzimeve është në vlerën 563,827 mijë lekë ndërsa të ardhurat e veta janë në vlerën 28,625 mijë lekë.

#### **b. Rëndësia e institucionit dhe e auditimit të tij:**

Rëndësia e auditimit financiar të Bashkisë Memaliaj për periudhën e aktivitetit 2024, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese, administruese dhe raportimit financiar, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

#### **c. Qëllimi i auditimit ku përcaktohet dhe periudha nën auditim, paraqitja e objektivave të cilat janë të njëjta me drejtimit e auditimit të tij:**

Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që t’i bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- ✓ *Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm;*
- ✓ *Auditimi i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore;*
- ✓ *Verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm;*

#### **d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave:**

Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve dhe regjistrimit në pasqyrat financiare. Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit.

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë

të planifikuara për t'u audituar. Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 11,227 mijë lekë, i cili është llogaritur mbi zërin e shpenzimeve. Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimi si: Kontrolli aritmetik; Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese; Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese; Kontrolli i vlerësimit; Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi; Verifikimi i transaksioneve Intervistimi; Raporte dhe informacione; Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.

#### **e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:**

Nga shqyrtimi i evidencave konstatohet se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 18 gjetje dhe ka dhënë 18 rekomandime të cilat i përkasin kategorisë Masa Organizative.

## **2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.**

### **f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:**

*Gjetjet më të rëndësishme shpjegohen shkurtimisht sipas drejtimeve më poshtë:*

- Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet më datë 01.01.2024, në vlerën 52,437,297 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 68,510,006 lekë. Kjo llogari nuk kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 68,510,006 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 26,094,899 lekë. Llogaria “Disponibilitete në thesar” është nënvlerësuar në vlerën 26,094,899 lekë.

- Llogaria 532 “Vlera të tjera” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 14,528,983 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 26,094,899 lekë me një rritje në vlerën 11,565,916 lekë. Në gjendjen e llogarisë 532 “Vlera të tjera” është përfshirë vlera prej 26,094,899 lekë që i përket 5% të garancive të punimeve si veprim kundërpattie e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”. Ndërkohë që shumatorja e llogarive 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” dhe 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të kuadrojë me mbylljen e gjendjes së llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”. Në llogarinë 532 “Vlera të tjera” kontabilizohen mjetet që ruhen në arkë në formën e pullave tatimore, pullave postare, bileta apo vlerave të tjera.

- Në llogaritë 423,429 “Personeli, paradhënie, defiçite, gjoba”, 431 “Tatim e taksa” dhe 436 “Sigurime shëndetësore” është kontabilizuar vlera totale prej 14,054,567 lekë në Aktiv, si kundërpatti e Pasivit për detyrimet të cilat i përkasin muajit dhjetor të vitit ushtrimor që likuidohen në muaj janar të vitit pasardhës, ndërkohë që si veprim kontabël duhej të kryej në llogarinë 4342 “Operacion me shtetin (të drejta)”.

- Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, përmbledhsja e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 48,437,125 lekë, 42 “Detyrime ndaj personelit” në vlerën 11,181,933 lekë, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 900,979 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 1,971,655 lekë, 464 “Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë” në vlerën 357,603 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 11,514,715 lekë ku totali shkon në vlerën 74,364,010 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në vlerën 944,650 lekë.

- Gjendja e llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve konstatohet se, për vitin 2024 ka kontrata që nuk kanë përfunduar si punime dhe likujdimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit konkretisht, “Rikonstruksioni i shkarjeve të rrugëve të Njërive Administrative Buz-Lutfinjë” në vlerën 20,675,896 lekë; “Skema ujitëse vaditëse “Kanali ujitës” Krahas” në vlerën 7,224,000 lekë; “Rikonstruksioni i Gjimnazit dhe ambienteve sportive “Sali Nivica” në vlerën 53,557,000 lekë; “Ndërtimi i Ujësjellësit Rajonal për fshatrat Vasjar, Iliras,

Qësarat, Anë Vjosë, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahës dhe Qytetin Memaliaj” në vlerën 179,028,083 lekë dhe “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara, Bashkia Memaliaj” në vlerën 30,934,440 lekë. Vlera prej 291,419,419 lekë e kontratave të sipërpërmendura duhet të ishte pjesë e gjendjes së llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” dhe jo pjesë e gjendjes së llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore” siç ka ndodhur në fakt, pasi ky aktiv nuk është kapitalizuar në vlerë të plotë.

- Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” më datë 01.01.2024, është në vlerën 39,991,494 lekë në të cilën duhet të paraqiten faturat e pa likuiduara nga Bashkia Memaliaj. Gjatë vitit 2024 ka pasur shtesa në vlerën 18,086,204 lekë dhe pakësime në vlerën 9,640,573 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 48,437,125 lekë. Në gjendjen e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” është përfshirë vlera prej 48,437,125 lekë që i përket debitorëve nga taksat dhe tarifatat vendore të cilat duhej të kontabilizoheshin në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

#### **g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:**

*Me qëllim zgjidhjen e problematikave të konstatuara nga gjetjet, janë dhënë disa rekomandime si vijon:*

- Drejtoria e Financës të marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2025 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

- Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e vlerës 26,094,899 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar të 5% të garancive të punimeve në llogarinë 532 “Vlera të tjera”, duke i kontabilizuar në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.

- Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e vlerës 48,437,125 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar të debitorëve nga taksat dhe tarifatat vendore në llogarinë 411 “Klientë e llogari të ngjajshme”, duke i kontabilizuar në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

- Gjendja e llogarisë 411 “Klientë e llogari të ngjajshme” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 39,991,494 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 48,437,125 lekë me një rritje në vlerën 8,445,631 lekë. Në gjendjen e llogarisë 411 “Klientë e llogari të ngjajshme” është kontabilizuar vlera 48,437,125 lekë që i përket debitorëve nga taksat dhe tarifatat vendore dhe përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, vlerë e cila duhej të kontabilizohej në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”. Referuar trajtimit kontabël në llogarinë 411 “Klientë e llogari të ngjajshme” kontabilizohen të ardhura nga mallrat apo shërbimi me arkëtim të mëvonshëm.

- Drejtoria e Financës në Bashkinë Memaliaj në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2025 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar, që për vlerat e detyrimeve afatshkurtra në lidhje me pagat, tatimin mbi të ardhurat, kontributet shoqërore e shëndetësore të muajit dhjetor të vitit ushtrimor, të paraqitura gabimisht në llogaritë e arkëtueshme analoge në aktiv të bilancit, ti kontabilizojë në mënyrë të saktë në gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” dhe në rakordim me gjendjen në llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”, në Formatin e Performancës së PF.

- Drejtoria e Financës në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktive afatgjata materiale dhe jo materiale, për pagesa të vlerave pjesore të AQT, duhet t’i evidentojë në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, deri në vlerë të plotë dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivit të kapitalizuar.

- Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e vlerës 48,437,125 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar të debitorëve nga taksat dhe tarifatat vendore në llogarinë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, duke i kontabilizuar në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

### **I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit:**

Bazuar në rezultatet e auditimit në Bashkinë Memaliaj, KLSH ka dhënë **“Opinionin i modifikuar/kualifikuar me rezervë”** për pasqyrat financiare. Referuar gjetjeve të auditimit për përmirësimin e gjendjes janë dhënë rekomandimet përkatëse të klasifikuara në rekomandime organizative.

## **OPINIONI I AUDITIMIT**

### **I. Opinion mbi pasqyrat financiare të vitit 2024:**

#### **a. Opinioni i modifikuar/kualifikuar me rezervë:**

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Memaliaj për periudhën ushtrimore nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

*Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, nga auditimi në pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Memaliaj janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale, por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionin të “modifikuar, me rezervë”, e shprehur kjo në bazën për opinionin.*

#### **Bazat për opinionin e modifikuar/kualifikuar me rezervë:**

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik. Përgjegjësitë tona lidhur me këto standarde janë përshkruar më hollësisht në seksionin “Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare”, pjesë e Raportit Përfundimtar të Auditimit. Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin e pasqyrave financiare të një institucioni ndërkombëtar, të cilat janë përmendur në ISSAI-n 5000- Auditimi i Institucioneve Ndërkombëtare Udhëzues për SAI-n. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përparatjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej **11,227 mijë** lekë, llogaritur mbi shpenzimet faktike të vitit 2024, si dhe anomalitë e mëposhtme:

- Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet më datë 01.01.2024, në vlerën 52,437,297 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 68,510,006 lekë. Kjo llogari nuk kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 68,510,006 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në

vlerën 26,094,899 lekë. Llogaria “Disponibilitete në thesar” është nënvlerësuar në vlerën 26,094,899 lekë;

- Në gjendjen e llogarisë 532 “Vlera të tjera” është përfshirë vlera prej 26,094,899 lekë që i përket 5% të garancive të punimeve si veprim kundërpatrie e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”. Ndërkohë që shumatorja e llogarive 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” dhe 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të kuadrojë me mbylljen e gjendjes së llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”. Në llogarinë 532 “Vlera të tjera” kontabilizohen mjetet që ruhen në arkë në formën e pullave tatimore, pullave postare, bileta apo vlerave të tjera;

- Në gjendjen e llogarisë 411 “Klientë e llogari të ngjajshme” është kontabilizuar vlera 48,437,125 lekë që i përket debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore dhe përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, vlerë e cila duhej të kontabilizohej në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”. Referuar trajtimit kontabël në llogarinë 411 “Klientë e llogari të ngjajshme” kontabilizohen të ardhura nga mallrat apo shërbimi me arkëtim të mëvonshëm;

- Në llogaritë 423,429 “Personeli, paradhënie, defiqite, gjoba”, 431 “Tatim e taksa” dhe 436 “Sigurime shëndetësore” është kontabilizuar vlera totale prej 14,054,567 lekë në Aktiv, si kundërpatri e Pasivit për detyrimet të cilat i përkasin muajit dhjetor të vitit ushtrimor që likuidohen në muaj janar të vitit pasardhës, ndërkohë që si veprim kontabël duhej të kryej në llogarinë 4342 “Operacion me shtetin (të drejta)”;

- Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, përmbledhsja e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 48,437,125 lekë, 42 “Detyrime ndaj personelit” në vlerën 11,181,933 lekë, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 900,979 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 1,971,655 lekë, 464 “Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë” në vlerën 357,603 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 11,514,715 lekë ku totali shkon në vlerën 74,364,010 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në vlerën 944,650 lekë;

- Nga auditimi konstatohet se llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” më datë 31.12.2024, është paraqitur në vlerën 11,514,715 lekë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Seksioni 3.1, pika 15, për arsye se kjo vlerë duhej të kontabilizohej në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”;

- Vlera e mbetur në fund të vitit 2024, prej 3,911,473 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”, për 20 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve;

- Llogaritë 210 “Toka, troje, terrene” të pasqyruara në bilanc për vlerën 119,998 lekë dhe 211 “Pyje, kullota, plantacione” në vlerën 277,000 lekë janë të paanalizuara, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave për këto llogari;

- Në gjendjen e kësaj llogarie është kontabilizuar vlera prej 3,312,750 lekë kosto historike që i përket automjeteve të dëmtuara të cilat nuk janë në gjendje pune, të konstatuara si të tilla në procesin e inventarizimit. Në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi nr. 1, pika 2.1,

vlera 3,312,750 lekë e cila i përket kostos historike mjete të dëmtuara duhej të debitohej në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”;

- Llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e veta”, është nënvlerësuar në vlerën 322,000 lekë;

- Vlera prej 291,419,419 lekë e kontratave të në proces duhet të ishte pjesë e gjendjes së llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” dhe jo pjesë e gjendjes së llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore” siç ka ndodhur në fakt, pasi ky aktiv nuk është kapitalizuar në vlerë të plotë.

- Në gjendjen e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” është përfshirë vlera prej 48,437,125 lekë që i përket debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore të cilat duhej të kontabilizoheshin në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

## II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 469/1 prot., datë 25.04.2025, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 28.04.2025, deri më 09.06.2025, në institucionin Bashkia Memaliaj u krye auditimi “Mbi auditimin financiar” për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024. Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. E.K. (Përgjegjës grupi)
2. M.H., anëtar
3. A.S., anëtar

## OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIME DHE METODOLOGJIA

**1. Objektivat dhe qëllimi:** Objekti i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2024, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, në referencë të kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve është paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe atë të shpenzimeve. Qëllimi i auditimit të pasqyrave financiare është që t’i bëhet e njohur nivelit drejtues të bashkisë, si dhe rritja e shkallës së besimit të përdoruesve të pasqyrave financiare, nëpërmjet shprehjes së një opinionit nga ana jonë nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën e zbatueshme të raportimit financiar, si një mekanizëm kontrolli për të siguruar përgjegjshmërinë në menaxhimin financiar.

**2. Identifikimi i çështjes:** Të përcaktojë nivelin e duhur të materialitetit, duke i mundur kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje dhe mbi bzaë risku, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t’i shërbej subjektit në marrjen e masave në përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes. Raporti Përfundimtar i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësisë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Memaliaj, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi. Në bazë të kriterëve të vlerësimit e

grykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara përse i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga grykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat. Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko financiare të Bashkisë Memaliaj.

**3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese:** Titullari i institucionit në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe Drejtori i Drejtorisë së Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, janë përgjegjës për gatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tjera.

**4. Përgjegjësitë e audituesve:** Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare Bashkisë Memaliaj në raport me aktet ligjore dhe nënligjore për buxhetin, menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së kërkuar dhe të vënë në dispozicion të auditimit. Audituesit kanë zbatuar parimet e auditimit financiar: Etika dhe pavarësia, Kontrolli i cilësisë, Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësi të tyre, si dhe Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit. Gjithashtu, janë zbatuar pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim, si Përkatësia, Plotësia, Saktësia dhe vlerësimi, Periudha, Klasifikimi dhe kutueshmëria, Ligjshmëria dhe rregullësia, Ekzistenca, Të drejtat dhe detyrimet, Plotësia, Vlerësimi dhe alokimi, Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet. Në cilësinë e audituesit të jashtëm publik, kemi përgjegjësinë për garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse veprimtaria e Bashkisë Memaliaj është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesit e KLSH kanë aplikuar grykimin dhe skepticizmin profesional gjatë veprimtarisë audituese. Audituesit kanë përgjegjësi në identifikimin e çështjeve më të rëndësishme lidhur me auditimin e veprimtarisë së subjektit, në raport me kriteret e paracaktuara të auditimit, të nxjerra nga aktet ligjore, nënligjore, si dhe ato rregullative mbi të cilat subjekti i audituar mbështetet në ushtrimin e veprimtarisë së tij, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë. Audituesit kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, paragrafi 44-51.

**5. Kriteret e vlerësimit:** Auditimi është bazuar në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.14, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, në kërkesat e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, si dhe në referenca të tjera ligjore sa më poshtë:

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare:

- Ligji nr. 25/2018, datë 10.05.2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;
- VKM nr. 248, datë 10.04.1998, “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe te njësjve që varen prej tyre” i ndryshuar;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimi i standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar;
- Udhëzimi përbashkët i Ministrit të Çështjeve Vendore dhe Ministrit Financave nr. 3237, datë 16.07.2015, “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”;
- Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 26, datë 27.09.2019, “Procedura për menaxhimin e vështirësive financiare për njësitë e vetëqeverisjes vendore”;

Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore:

- Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në RSH” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave lokale” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare” i ndryshuar;
- VKM nr. 170, datë 25.04.2002, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre” i ndryshuar;
- VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”;
- Udhëzim i Ministrisë së Financave nr. 24, datë 02.09.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;

Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave:

- Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar;
- Ligji nr. 10405, datë 24.03.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve” i ndryshuar;
- VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë” i ndryshuar;
- VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për pagat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar.

**6. Standardet e auditimit:**

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të Auditimit Financiar”;

- ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”;
- INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi Standardet e Kontrollit të Brendshëm për Sektorin Publik”;
- INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”;
- INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë” etj.;
- Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- Manuali i Auditimit Financiar dhe i Përputhshmërisë të KLSH-së;
- Manuali i Auditimit të Brendshëm;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit mbi Raportimin e Audituesit të Pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualet e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t etj.;
- Kodit Etik dhe Rregullorja e Procedurave të Auditimit të KLSH.

**7. Metoda e auditimit:** Është përdorur metoda e auditimit mbi bazë risku dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, bëhet përzgjedhja e kampioneve për ekzaminim në zërat e shpenzimeve.

*Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin<sup>1</sup>:*

Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar.

*Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit:*

*1. Kontrolli aritmetik:*

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve);

*2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese:*

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë asnjë gabim aritmetik, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (Urdhër shpenzimeve) konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar. Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar;

*3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese:*

<sup>1</sup> ISSAI 1320 (ISA 320) trajtojnë përgjegjësinë e audituesit për të zbatuar konceptin e materialitetit në planifikimin dhe kryerjen e një auditimi të pasqyrave financiare, në funksion të zbulimit dhe korrigjimit të anomalive. Një trajtim i tillë i ngjashëm mund të perdoret edhe në rastet e auditimit të përputhshmërisë, ku natyrisht një rol të rëndësishëm ka gjykimi profesional i audituesit.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminonj përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, duke u siguruar edhe për ekzistencën reale të aktiveve në subjekt;

#### 4. Kontrolli i vlerësimit:

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre;

#### 5. Konfirmim nga të tretët:

Nëse subjekti që auditohet ka të konfirmuara (Rakorduar) me të tretët informacionet që vërtetojnë ekzistencën e operacioneve, detyrimeve, të tepricave ose të çdo regjistrimi tjetër;

#### 6. Kontrolli sipas një treguesi:

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim: mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, të emrave, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave etj.

- Verifikimi i transaksioneve është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre.
- Intervistimi është përdorur gjatë marrjes verbale të informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- Raporte dhe informacione janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe çështjet për trajtim.

**8. Dokumentimi i auditimit:** Është mbështetur në kërkesat e Manualeve të Auditimit Financiar dhe atij të përputhshmërisë, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit: ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore.

Nga audituesit është përgatitur dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë të zbatueshme. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit kanë shfrytëzuar në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre. Në përfundim të auditimit në terren, mbi Akt-Konstatimin e mbajtur, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit ky Raport Përfundimtar Auditimi.

### **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**

#### **1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin “Bashkia Memaliaj”:**

Bashkia Memaliaj kufizohet në veri me Bashkinë Mallakastër, në lindje me Bashkinë Këlcyrë, në jug me Bashkinë Tepelenë dhe në perëndim me Bashkinë Himarë dhe Selenicë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Memaliajt. Në përbërje të kësaj Bashkie ndodhen 6 Njësi Administrative: Memaliaj, Memaliaj Fshat, Lutfinje, Buz, Krahës dhe Qesarat. Infrastruktura rrugore e Bashkisë Memaliaj ka njohur një përmirësim relativ gjatë viteve të fundit në përfundimin e ndërtimit të akseve rrugore Tepelenë - Memaliaj dhe Fier - Memaliaj. Bashkia Memaliaj është lidhur me linja të transportit publik me kryeqytetin dhe qytete e afërta. Sipërfaqet e gjelbërta në qytet janë 192,625 m<sup>2</sup>; mbulime me ndriçim në zonat urbane dhe rurale vërtet qyteti; shërbim me ujë dhe kanalizime,

mbulimi 10%, mbulimi me shërbim pastrimi në masën 30%. Në territorin e Bashkisë së Memaliajt gjenden 15 rezervuare në funksion të ujitjes së tokave Bujqësore, gjë që favorizon kultivimin e produkteve bujqësore në këtë zonë. Prej vitesh është evidentuar potenciali energjitik në segmentet e Kalivaçit. Bashkia Memaliaj është e pasur me bimësi si në loje ashtu dhe në shtrirje. Në të ndeshen nga brezi i shkurreve që shtrihet deri në lartësinë 600 - 800 m, brezi i dushkut 800 - 1200 m, pyjet foragjere, halore dhe të përzier dhe deri në kullotat alpine me lartësi afër 1,000 m. Bashkia e Memaliajt ka ende burime minerare në formën e rezervave të qymyrgurit me fuqi të lartë kalorifike (por me përqindje të lartë sqfuri 3 herë më tepër se normat e BE).

## **2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.**

### **2.1. Vlerësimi i funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe auditit të brendshëm.**

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, të cilat vendosen, ruhen dhe përditësohen rregullisht nga titullari i njësisë publike dhe vihen në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar riskun e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet veprimtarive efektive, efçiente dhe me ekonomi, pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat, informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota dhe mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

#### **I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”:**

Mjedisi i kontrollit është bazë për menaxhimin e fondeve në njësinë publike, ai përbën themelin ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Ky komponent përbëhet nga:

##### **1.1. Integriteti dhe Vlerat Etike:**

Nëpunësit e Bashkisë Memaliaj duhet të respektojnë rregullat dhe parimet e përcaktuara në Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, Ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

- Bashkia Memaliaj disponon Kodin e Etikës të miratuar me Vendimin nr. 39, datë 21.07.2022, të Kryetarit të Bashkisë, në të cilën përfshihen rregullat e etikës për zbatim nga stafi i punonjësve të bashkisë gjatë veprimtarisë në këtë institucion.

- Bashkia Memaliaj nuk ka hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit. Këto veprime janë në kundërshtim me Manualin për MFK-në i miratuar me Urdhrin e MFE-së nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1.

- Në Bashkinë Memaliaj, ankesat dhe kërkesat e ndryshme të paraqitura pranë saj, regjistrohen në Zyrën e Protokollit të institucionit me një ndalesë dhe më pas bëhen raportimet e nevojshme në sektorët përkatës. Në vazhdim të procesit, bëhet kthimi i përgjigjeve sipas afateve të përcaktuara në përputhje me Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014, “Për të drejtën e informimit” dhe Urdhrin e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale “Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

- Bashkia Memaliaj nuk ka kryer procesin e vlerësimit të punonjësve për periudhën në auditim. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, VKM nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë” dhe Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

##### **1.2. Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA)/Bordi apo Këshilli i Drejtuesve demonstron pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje:**

Në rregulloren e brendshme të institucionit janë të përcaktuara procedurat për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse të cilat, përcaktojnë rolin, fushëveprimin e nëpunësit autorizues dhe të stafit menaxherial. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion prej institucionit konstatohet se:

- Bashkia Memaliaj ka të përcaktuar dhe kryen sipas procedurës së miratuar në rregulloren e brendshme hartimin, miratimin, ndjekjen dhe raportimin e brendshëm sa i përket realizimit të planeve mujore nga sektorët në Aparatin e Bashkisë, Administratorët e Njësive Administrative si dhe Drejtorët e njësive të varësisë për informacion të Titullarit të Bashkisë sipas fushave që ato mbulojnë në përputhje me Manualin për MFK-në të miratuar me Urdhrin e MFE-së nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1.
- Në Bashkinë Memaliaj mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm, nuk ka plan menaxhimi për veprime korrigjuese lidhur me mangësitë e evidentuara në këtë drejtim.
- Nga njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë.
- Titullari i institucionit merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga Auditimi i Brendshëm, nëpërmjet veprimtarisë audituese që ai kryen.
- Këshilli bashkiak me kompetencat e tij ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së Bashkisë nëpërmjet vendim-marrjes.

### **1.3. Titullari/Nëpunësi Autorizues (NA) krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë:**

- Bashkia Memaliaj ka hartuar dhe miratuar deklaratën e misionit dhe dokumentin e PBA-së. Në dokumentet e PBA-ve, nga ana e këtij institucioni është miratuar strategjia me objektivat dhe prioritetet strategjike, në përputhje me ligjin organik të buxhetit si dhe plan veprimi i menaxhimit të financave, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.
- Mënyra e njohjes së punonjësve me rregulloren e brendshme, është kryer me metodën elektronike.

### **1.4. Njësia publike demonstroi angazhim në realizimin e kompetencave:**

Nëpunësit e Bashkisë Memaliaj i rregullojnë marrëdhëniet e punës në nivel sektori, përgjegjës sektori apo specialist me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tij, për sa i përket punonjësve administrativ dhe terrenit i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Referuar Kreut III, pika 3.1, “Mjedisi i kontrollit të brendshëm”, të Manualit të MFK-së i miratuar me Urdhrin e MFE-së nr. 108, datë 17.11.2016, përcaktohet që:

Politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë:

- Një procedurë transparente për rekrutimin dhe emërimin e punonjësve;
- Kriteria dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit, që synojnë të fuqizojnë kapacitetin administrativ të njësive dhe të krijojnë një ekip pune të besueshëm dhe kompetent;
- Zhvillimin dhe miratimin e politikave, rregullave dhe procedurave të zbatueshme, që janë në harmoni me dispozitat ligjore të vlefshme për rekrutimin, emërimin, vlerësimin, trajnimin, shpërblimin dhe motivimin e stafit;

Në rregulloren e brendshme të institucionit për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune nuk është përcaktuar mënyra e rekrutimit të tyre si dhe nuk janë përcaktuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira.

### **1.5. Njësia publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale:**

Titullari i njësisë publike duhet të krijojë Grupin e Menaxhimit Strategjik, (në vijim GMS) me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësisë. GMS është një element integral i përgjegjshmërisë dhe qeverisjes publike, dhe luan një rol kyç për sa i takon, integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm dhe sjelljes etike. GMS ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike.

GMS duhet të kuptojë sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë, të garantojë se komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe menaxhimi efektiv i riskut janë të pranishëm dhe funksionojnë me efektivitet brenda njësisë. Me shkresën nr. 1026 prot., datë 30.04.2024, dhe shkresën nr. 155 prot., datë 03.10.2024, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik i përbërë nga 8 (punonjës), në përputhje Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 8, pika 8, gërma “b”, neni 27, pikat 1-2.

Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues dhe menaxherë të tjerë të njësisë, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre. Mënyra e delegimit të detyrave është e përcaktuar në rregulloren e brendshme të institucionit.

### **II. Komponenti “Menaxhimi i riskut”:**

Risku zakonisht përcaktohet si pasiguria e rezultatit, qoftë kjo mundësi pozitive apo negative e veprimeve dhe ngjarjeve. Kjo është mundësia që një ngjarje e caktuar, e cila do të ketë ndikim në arritjen e objektivave të njësisë, mund të ndodhë. Risku matet me efektin e tij dhe shkallën e mundësisë së ndodhjes.

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e ngjarjeve të mundshme apo situatave të cilat mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësisë dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen.

Titullari i njësisë publike është përgjegjës për, zhvillimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e strategjisë për menaxhimin e riskut brenda njësisë së tij, analizimin dhe rifreskimin e kontrolleve që synojnë minimizimin e riskut, sipas strategjisë së riskut të miratuar.

Menaxhimi i riskut mundëson vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion, hapa këto të cilat kanë të bëjnë me përcaktimin e prioritetëve lidhur me shmangien e problemeve të ardhshme që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura.

Strategjia e riskut është përcaktuar si qasje organizative në drejtim të menaxhimit të riskut nga ana e titullarit të institucionit dhe e pasqyruar në politikat e nivelit të lartë të njësisë e më tej. Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si duhet të sillen institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut.

Strategjia e riskut të njësisë duhet të përcaktojë në mënyrë të qartë strukturat për menaxhimin dhe kontrollin e risqeve, si duhet të trajtohen risqet në nivel strategjik, në nivel programi dhe në nivel aktiviteti, strukturat për monitorimin dhe vlerësimin e tij, kriteret për përcaktimin e risqeve më të mëdha, mekanizmat e regjistrimit të riskut si dhe kriteret për matjen e riskut.

- Nuk janë identifikuar dhe vlerësuar risqet përmes një procesi të strukturuar dhe sistematik që përfshin vlerësimin e rëndësisë potenciale dhe priorizimin e risqeve të përputhshmërisë. Nuk ka urdhër për përcaktimin e grupit koordinues teknik për procesin e menaxhimit dhe raportimet mbi risqet, nuk janë hartuar strategjia dhe regjistri i riskut, për vitin 2024, ku të përfshihen të gjitha strukturat e Bashkisë Memaliaj.

- Bashkia Memaliaj nuk ka hartuar listën e proceseve/manualeve e procedurave të punës. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar

dhe kontrollin” i ndryshuar, dhe Manualin për MFK-në miratuar me Urdhrin e MFE-së nr. 108, datë 17.11.2016.

### **III. Komponenti “Aktivitet e kontrollit”:**

Sistemi me dy firma është një procedurë e cila kryhet për të vërtetuar saktësinë e të dhënave të përfshira në dokument. Detyrimet financiare si nënshkrimi i kontratave, urdhër-shërbimet dhe kryerja e pagesave, sistemi i firmës së dyfishtë jep garancinë se marrja përsipër e detyrimit financiar apo pagesa bëhet nga personi i autorizuar dhe se nuk ka shkelje të disiplinës financiare për pagesat.

Qëllimi i kësaj procedure është të garantojë se personi përgjegjës për regjistrimet në kontabilitet është i informuar për detyrimin financiar që do të merret përsipër apo që do të paguhet dhe do të kryejë saktë veprimet e kontabilitetit.

Likuidimet e transaksioneve nënshkruhen nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues të cilët janë konfirmuar nga MFE për autorizimin/kryerjen e veprimeve me Degën e Thesarit.

Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme.

Përveç kësaj gjurma e auditimit jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t'i verifikuar këto transaksione dhe operacione.

Titullari i njësisë publike, miraton gjurmën e auditimit për procedura që lidhen me veprimtaritë kryesore të njësisë dhe siguron që, të gjitha operacionet e njësisë dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm apo autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit duhet të ketë në përbërje të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme të saj. Gjurma e auditimit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces.

Në Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike” përcaktohet se, “Nëpunësi Autorizues i njësisë publike është përgjegjës për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, struktura, programet, aktivitetet dhe proceset e drejtuara prej tij në përputhje me parimet e ligjshmërisë, menaxhimit të shëndoshë financiar dhe transparencës”.

Nëpunësi Autorizues duhet të sigurojë që do të ndiqet qasja e përgjithshme e rekomanduar për ngritjen, vlerësimin dhe përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, të sigurojë se në përgatitjen e “Gjurmës së auditit për proceset kryesore të punës” do të përfshihen hapat kryesorë të vlerësuara të rëndësishëm për një sistem të shëndoshë të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

- Për vitin 2024, Bashkia Memaliaj nuk ka hartuar, miratuar dhe arkivuar gjurmën e auditimit e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre dhe synon të ripërshkrojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 16, pika 2-3 dhe Manuali për MFK-së i miratuar me Urdhrin e MFE-së nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.3.

Titullari i njësisë ka përgjegjësi për vendosjen e rregullave dhe procedurave për njoftimin, shqyrtimin, zbulimin dhe raportimin e dobësive administrative, mospërputhjeve dhe shkeljeve, që krijojnë terren për korrupsion, mashtrime, apo parregullsi. Procedurat antikorrupsion, përfshijnë:

- Kontrollat parandaluese;

- Një sistem për investigim të brendshëm të paralajmërimeve të hershme për korrupsion, mashtrime dhe parregullsi;
  - Një sistem për zbulimin e mashtrimeve dhe parregullsive;
  - Një sistem për raportimin e parregullsive të gjetura, i cili duhet të përshkruajë qartësisht linjën e brendshme dhe të jashtme të raportimit, pa rënë ndesh me të drejtën kushtetuese të individit;
  - Procedurat e sinjalizimit.
- Në Bashkinë Memaliaj është miratuar Rregullorja për Parandalimin e Konfliktit të Interesit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike me nr. 1277 prot., datë 28.07.2022, dhe ka hyrë në fuqi me Vendimin nr. 41, datë 28.07.2022, të Kryetarit të Bashkisë.
- Bashkia Memaliaj nuk ka një procedurë të veçantë lidhur me mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave dhe analizën e tyre, për të bërë të mundur identifikimin e shkaqeve dhe eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 20.

#### **IV. Komponenti “Monitorimi”:**

Kontrolli i brendshëm mbulon vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Sistemi dhe komponentët e tij mund të vlerësohen nëpërmjet procesit të vazhdueshëm të monitorimit dhe nëpërmjet një sistemi vlerësimesh të shkëputura.

Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit kërkon monitorim të vazhdueshëm për të mundur vlerësimin sa më të mirë të funksionimit të këtij sistemi, për të bërë përditësimet në kohën e duhur në rast të ndryshimit të rrethanave dhe mënyrave të operacioneve, si dhe për të identifikuar masat që synojnë një zhvillim të vazhdueshëm të sistemit.

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, monitorimi synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë, sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficientë me kalimin e kohës.

Monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm bëhet për të vlerësuar cilësinë e sistemit dhe të performancës në kohë. Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit duhet të bëhet nëpërmjet: monitorimit të vazhdueshëm, vetëvlerësimit, Auditit të Brendshëm.

Nëpërmjet vetëvlerësimit një përdorues i buxhetit përcakton nëse ka apo jo një sistem të përshtatshëm të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në të cilin rregullat dhe procedurat sigurojnë se operacionet janë duke u kryer rregullisht, në mënyrë etike, ekonomike, efikase dhe efektive. Duke plotësuar pyetësorin e vetëvlerësimit çdo nëpunës autorizues për çdo vit përgatit një deklaratë “Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm”, në të cilën ai deklaron se si sistemi i kontrollit të brendshëm mbështet arritjen e politikave të njësisë, qëllimet dhe objektivat, ndërsa ruan fondet publike dhe pasurinë e njësisë ekonomike. Kjo deklaratë duhet të mbulojë vitin financiar paraardhës.

Në deklaratë, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të përshkruajë dobësitë e sistemit të kontrollit dhe planet për trajtimin e tyre. Me nënshkrimin e deklaratës, drejtuesi i njësisë merr përgjegjësinë për vërtetësinë e informacionit të deklaruar.

Qëllimi i kësaj deklarate është rritja e llogaridhënies së menaxhimit dhe inkurajimi i përpjekjeve për përmirësime në sistemin e kontrollit të brendshëm.

Çdo vit, nëpunësi autorizues i çdo njësie publike duhet të kryejë një vetëvlerësim mbi gjendjen dhe cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë, dhe të paraqesë një raport mbi gjetjet e këtij vetëvlerësimi te nëpunësi i parë autorizues në Ministrinë e Financave.

- Bashkia Memaliaj me shkresën nr. 505/1 prot., datë 06.03.2024, ka hartuar dhe dërguar në MFE deklaratën për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm, raportin vjetor për funksionimin e

sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe pyetësorin e vetëvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, për vitin 2023 në funksion të realizimit të pesë fushave në të cilat funksionon MFK në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, nenin 18, pika 1.

- Për vitin 2024 nuk është hartur dhe dërguar plani i veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin pranë MFE, në përputhje me Udhëzimin e MFE-së nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 2.2, dhe Manuali për MFK-së i miratuar me Urdhrin e MFE-së nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III.

#### **V. Komponenti “Informimi dhe komunikimi”:**

Titullari i njësisë publike miraton dhe vë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi që sigurojnë:

- Identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.
- Një komunikim efektiv, si vertikal ashtu edhe horizontal, në të gjitha nivelet e hierarkisë së njësisë.
- Ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të informacionit për menaxhimin e njësisë që ka si qëllim shpërndarjen e udhëzimeve dhe urdhrave të qartë dhe të saktë për rolet e çdo punonjësi të përfshirë në menaxhimin financiar dhe kontrollin.
- Ngritjen e një sistemi për dokumentimin dhe qarkullimin e dokumenteve, që përmbajnë rregullat për përgatitjen, formatimin, lëvizjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumenteve, në bazë të rregullave të nxjerra nga Ministri i Financave.
- Dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.

Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, si dhe ndërmjet njësisë publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet.

Menaxhimit duhet t’i jepen raporte të nevojshme mbi performancën (përmbyshjen e detyrave) e njësisë në raport me objektivat e caktuara, për të bërë të mundur që ata të marrin përsipër përgjegjësitë e tyre me efikasitet dhe efektivitet.

Zhvillimi ose rishikimi i sistemeve të informacionit duhet të bazohet në një plan strategjik për sistemet e informacionit të lidhur me strategjinë e njësisë dhe që ti përgjigjet përmbyshjes së objektivave në nivel aktiviteti dhe në nivel objektivash të përgjithshme për mbarë njësinë publike. Mbështetja e menaxhimit për zhvillimin e sistemeve të nevojshme të informacionit duhet të shfaqet me angazhimin e burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiare. Informacioni është i dobishëm vetëm nëse arrin në kohën e duhur, përmban hollësi të mjaftueshme dhe është i përshtatshëm për përdoruesin.

Shkëmbimi i informacionit në Bashkinë Memaliaj dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht, funksionojnë, sipas nivelit të hierarkisë në mënyrë shkresore dhe elektronike. Sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim, pavarësisht se informacioni është i mjaftueshëm për zbatimin e detyrave.

#### **Organizimi dhe funksionimi i strukturës së Njësisë të Auditit të Brendshëm:**

Struktura e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Memaliaj funksionon në nivel sektori sipas VKB-së nr. 90, datë 28.12.2023, ku ka marrë konfirmimin mbi bazueshmërinë ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr. 1083 prot., datë 08.01.2024.

### **Përbërja profesionale dhe kualifikimi i punonjësve të njësisë së auditimit të brendshëm:**

Nga auditimi i dokumentacionit të vëne në dispozicion dhe që ndodhet pranë zyrës së burimeve njerëzore në Bashkinë Memaliaj, konstatohet se stafi i NJAB për vitin 2024, kjo njësi auditimi është organizuar në nivel sektori me strukture: 1 Përgjegjës Auditimi dhe 2 Specialist Auditues. Profili arsimor i punonjësit, rezulton që të jetë i diplomuar në fushën e ekonomisë, i certifikuar, me përvojë pune në fushën e auditimit për 5 vite, si dhe me përvojë profesionale në fushën ku janë diplomuar për 25-35 vite. Struktura e kësaj njësie auditimi, në formë tabelore për periudhën e audituar për vitin 2024, paraqitet si më poshtë:

Nr.	Periudha	Funksioni	Emëruar	Arsimimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime të vijueshme
1.	F.K.	P/Auditimi	06.01.2020	Ekonomist	32	5	Në vitin 2012	Po

### **Dokumentacioni baze mbi të cilën ushtron aktivitetin Njësia e Auditimit të Brendshëm:**

Nga vlerësimi i kryer nga grupi i auditimit, për vitin 2024, pasi shqyrtoi evidencat dhe korrespondencën e kryerjes dhe raportimit të veprimtarisë audituese, planifikimin strategjik dhe atë vjetor, raportimin vjetor dhe periodik, konstaton se dokumentacioni bazë mbi të cilën ushtron veprimtarinë NJAB, është si më poshtë:

**1. Karta e Auditimit të Brendshëm** në NJAB Bashkia Memaliaj është miratuar me Vendimin nr. 147, datë 08.11.2018, e përmirësuar me Vendimin nr. 38, datë 23.05.2023.

**2. Plani strategjik si dhe plani vjetor** për vitin 2024, janë hartuar sipas kërkesave të nenit 18/2, të ligjit organik mbi auditimin dhe të Seksionit 3, Kreu II të Manualit për ABSP, si dhe të nenit 14, të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” i ndryshuar, të cilat janë miratuar nga Kryetari i Bashkisë Memaliaj, me shkresën nr. 2055 prot., datë 16.10.2023, si dhe i janë dërguar strukturës përgjegjëse Drejtorisë së Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në MFE me shkresën nr. 2055/1 prot, datë 16.10.2023.

Plani vjetor i auditimit si një dokument bazë i veprimtarisë audituese, parashtron kritere e procedura të cilat janë parashikuar në dispozita ligjore, si fushat prioritare, frekuencën e auditimeve, përmirësimet e kapaciteteve audituese, zhvillimin e burimeve njerëzore, bilancin e burimeve dhe nevojave për auditim, koston e auditimit, etj.

Në planin vjetor të auditimit janë përfshirë për auditim sistemet me risk të mesëm dhe të lartë, ku drejtimet kryesore të auditimit, kanë qenë:

- Vlerësimi mbi funksionimin e sistemit në lidhje me zbatimin e rekomandimeve që janë lënë në auditimet e mëparshme, nga audituesit e brendshëm si në Bashkinë Memaliaj, Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, si dhe tek Klubi Sportiv Memaliaj.

- Vlerësimi i situatës mbi detyrimet e prapambetura, si për Bashkinë Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike, si dhe tek Klubi Sportiv Memaliaj.

- Dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e zbatimit nga subjekti i audituar të ligjeve dhe rregullores së brendshme në zhvillimin e veprimtarisë së Institucionit, mbi menaxhimin e burimeve që krijojnë të ardhura.

- Qëllimi i angazhimit të auditimit me bazë përputhshmërie dhe financiar është të vlerësojë zbatimin e dispozitave ligjore e rregullave, t’i japë aksionarit të vetëm (Bashkia Memaliaj) dhe menaxhimit siguri objektive e të pavarur, me qëllim për të përmirësuar veprimtarinë dhe performancën e “Klubi i Futbollit Memaliaj” Sh.A.

- Dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e zbatimit nga subjekti i audituar, të ligjeve dhe rregullores së brendshme në zhvillimin e veprimtarisë së kësaj Ndërmarrje, në drejtim të përdorimit të burimeve financiare apo dhe performanca e veprimtarisë së kësaj Ndërmarrje të Shërbimeve Publike.

- Vlerësim i rregullshmërisë ligjore bazë dhe mbështetëse si dhe rregullorja që drejton veprimtarinë e subjekteve të audituara.

Nga NjAB, referuar kërkesave të nenit 14, pika “ç” të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, është hartuar **Raporti Vjetor i veprimtarisë, së bashku me pasqyrat përkatëse dhe pyetësonin e vetëvlerësimit** për auditimin e brendshëm, miratuar nga Titullari dhe dërguar tek Drejtorja e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave, me shkresën nr. 410 prot., datë 14.02.2024. Veprimtaria e AB për periudhën 2024, i është përmbajtur planit vjetor dhe strategjik të saj, në përputhje me standardet procedurat dhe etapat e auditimit të përcaktuara në Manualin e AB dhe Udhëzimin në fuqi, në fushën e AB.

#### **Vlerësimi i procedurave dhe zbatimit të standardeve në kryerjen e auditimit të brendshëm:**

Nga ana e NjAB Bashkia Memaliaj, planifikimi i një angazhimi është realizuar duke respektuar kërkesat e Manualit të AB kapitulli IV, pika 4.1.1 “Planifikimi i një angazhimi”, ku nga ana e grupit të auditimit janë zhvilluar takime për njohjen paraprake të subjektit që do të auditohet me subjektin, veprime të cilat janë të dokumentuara me shkrim në procesin e mbledhjes së informacionit dhe përgatitjes së programit të angazhimit.

Gjatë kryerjes së angazhimit nga NjAB janë respektuar fazat e planifikimit, si Autorizimi për fillimin e auditimit, Njoftimin paraprak për fillimin e angazhimit, takimin fillestar, deklaratën e pavarësisë, vlerësimin e riskut, përcaktimin e drejtimeve të auditimit, duke e shoqëruar me testet përkatëse, përcaktimi i kostos së veprimit, masat për sigurimin e cilësisë, etj.

Janë respektuar kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm, Kapitulli IV, pika 4.1.6 “Përgatitja e programit të angazhimit...”, ku për të arritur objektivat e angazhimit, janë trajtuar si fusha prioritare duke planifikuar, auditimin mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i brendshëm, vlerësimi i sistemit mbi planifikimin dhe realizimin e të ardhurave, etj., pra rezulton se janë zbatuar drejt kriteret, lidhur me fushat prioritare për auditimin e subjekteve, pasi ato kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimtarisë në përputhje me risqet e subjekteve.

Vlerësojmë se në mbështetje me Manualin e AB të miratuar me Urdhrine MF nr.100, datë 25.10.2016, (seksioni VI, kreu III, pika 1), përgjithësisht programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimet dhe grupin e punës.

#### **Vlerësimi i procedurave të parashikuara për raportimin dhe komunikimin e auditimit si: hartimi i projekt-raportit të angazhimit, takimet me palën e audituar, hartimi i raportit final, trajtimi i observacioneve, përgatitja e memorandumit.**

Nga NjAB të Bashkisë janë respektuar kërkesat e manualit të AB, lidhur me procedurat e hartimit të dokumenteve të auditimit, siç përcakton manuali i auditimit, pra janë respektuar hapat e një misioni angazhimi që nga procesi i planifikimit (përgatitja) e misionit të angazhimit, puna në terren, pasqyrimi i punës audituese (dokumentimi) i saj.

Për rastet e parregullsive dhe shkeljeve të konstatuara nga Auditimi gjatë ekzaminimit të praktikave dhe dokumentacionit kontabël e administrativ, janë mbajtur dokumentacioni i nevojshëm me personat përgjegjës për fiksimin e shkeljeve të ligjshmërisë dhe të disiplinës financiare.

Kjo strukturë ka plotësuar konformë kërkesave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, edhe pyetësonin mbi veprimtarinë e saj, duke dhënë opinionin mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në subjektet që ajo auditon, kjo sipas nivelit të riskut, veprim i reflektuar tek formati 7 kapitulli II të MAB.

Në dosjet e auditimit ndodhen konfirmimet e raporteve të bëra nga subjektet e audituara, në zbatim të rekomandimeve të dhëna nga njësia e auditimit, veprime, të cilat përputhen me kërkesat e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe të Kapitullit VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese” të MAB, miratuar me Urdhër të MFE-së me nr. 100, datë 25.10.2016, konkretisht:

- Autorizimi për caktimin e grupit të punës për të kryer angazhimin e auditimit;
- Njoftimi paraprak për fillimin e angazhimit të auditimit;
- Takimi fillestar për fillimin e misionit të auditimit;
- Programi i angazhimit të auditimit;
- Dokumentet që lidhen me kryerjen e angazhimit të auditimit;
- Testet dhe shënimet e mbajtura nga audituesi;
- Takimi i ballafaqimit përfundimtar të misionit të auditimit;
- Projekt Raporti i auditimit;
- Raporti Përfundimtar i auditimit;
- Memo ( përmbledhja e shkurtërpërfundimtare) e cila i është paraqitur titullarit të Institucionit;
- Monitorimi i brendshëm të aktivitetit të auditimit të brendshëm nga çdo auditues;
- Kontrolli i vlerësimit të cilësisë për monitorimin e brendshëm për çdo auditim.

#### **Vlerësimi i procedurave për rishikimin e brendshëm të cilësisë së punës audituese:**

Nga dosjet objekt auditimi për periudhën audituese, grupi i auditimi konstatoi se, procedurat e rishikimit të brendshëm të cilësisë së punës audituese janë ndjekur vazhdimisht, siç është parashikuar në kërkesat e manualit të AB (Kap. IV, Pika 4.8.3).

#### **Vlerësimi i dokumentimit të punës audituese:**

Nga NjAB është plotësuar inventari i sugjeruar i dosjes koherente të auditimit, si dhe dosjet e përhershme për të gjitha subjektet që auditohet nga kjo njësi, ku janë plotësuar me dokumentacionin përkatës, kjo sipas kërkesave të MAB Kapitulli VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese”, formati 1 “Inventari i sugjeruar i dosjes koherente të auditimit” si dhe pikës 6.3 “Dosja e përhershme”.

Nga ekzaminimi i dokumentacionit, u vu re se të gjithë dosjet e evaduar janë arkivuar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat” dhe në zbatim të tij “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor të Republikës së Shqipërisë”. Dosjet e auditimit vlerësohen të plotësuar sipas kërkesave të manualit, dhe të gatshme për arkivim. Të dhënat mbi subjektet e audituara për vitin 2024, paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

Nr.	Subjekte të Audituar sipas viteve			Niveli i Riskut
	Planifikuar 2024	Realizuar 2024		
1	Bashkia Memaliaj	Sektori Taksa Tatimeve		I lartë
2	Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	Ndërmarrja e Shërbimeve Publike		I mesëm
3	Klubi Sportiv Memaliaj	Klubi Sportiv Memaliaj		I mesëm
4	Bashkia Memaliaj, NSh, Futboll Klub Memaliaj	Bashkia Memaliaj, NSh, Futboll Klub Memaliaj		I Mesëm

Nr.	Periudha	Të dhëna sipas raportimit								
		Auditime të planifikuara	Auditime të realizuara	Nga të realizuarat, sipas llojit					Zbatim Rekomandime	
				Përputhshmëri	Financiare	Kombinuar	Performace	Tematik		Teknologjisë së informacionit
1	Viti 2023	7	7	7						1

Nr.	Periudha	Të dhëna sipas raportimit				Sipas raportimit			
		Rekomandime të shprehura në numër				Rekomandime të shprehura në vlerë (shpërblim dëmi)			
		Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pazbatuar	Gjithsej në numër	Zbatuar	Në proces	Pa zbatuar
1	Viti 2022	41	25	5	11	0	0	0	0
<b>Totali</b>		<b>41</b>	<b>25</b>	<b>5</b>	<b>11</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

## **2.2. Auditimi i procedurave për përgatitjen, paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore.**

**2.2.1.** Auditimi i përkatësisë, plotësisë dhe saktësisë së paraqitjes së aktiveve afatgjata në pasqyrën e pozicionit financiare:

- Regjistrimi fillestar dhe klasifikimi i tyre;
- Inventarizimi periodik;

**2.2.2.** Auditim i saktësisë dhe raportimit të paraqitjes në pasqyrën e pozicionit financiar të:

- Llogarive të arkëtueshme;
- Llogarive të pagueshme;

**2.2.3.** Auditim i plotësisë dhe saktësisë së pasqyrës së performancës financiare:

- Mbi realizimin dhe regjistrimin e të ardhurave nga burimet e veta dhe transfertat;
- Mbi realizimin dhe regjistrimin e shpenzimeve.

### **Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimit të pasqyrave financiare:**

Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, si dhe dispozita ligjore të tjera rregulluese.

### **Hartimi i pasqyrave financiare:**

Për vitin 2024 në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, janë përgatitur pasqyrat financiare të përbëra si më poshtë:

- Formati nr. 1. Pasqyra e pozicionit financiar.
- Formati nr. 2. Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).
- Formati nr. 3. Pasqyra e flukseve monetare (Cash Flow).
- Formati nr. 4. Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.
- Formati nr. 5. Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.
- Formati nr. 6. Investimet dhe burimet e financimit.
- Formati nr. 7/a. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).
- Formati nr. 7/b. Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).
- Formati nr. 8. Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

### **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare:**

Pasqyrat financiare të Bashkisë Memaliaj për vitin ushtrimor 2024 janë të nënshkruara nga z. A.M. Kryetar i Bashkisë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe z. B.C. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues ku janë depozituar pranë Degës së Thesarit Tepelenë me shkresën nr. 738 prot., datë 27.03.2025, dhe konfirmuar nga DTH Tepelenë me shkresën nr. 108 prot., datë 27.03.2025, brenda afatit ligjor.

### **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:**

Për vitin 2024 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e Klasës 6 dhe Klasës 2 me akt-rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokument i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e

vjetor konstatohet se nuk ka diferenca. Për këtë është përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

**Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit:**

Për t'u siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testimet në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- Mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- Mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- Tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të ushtrimit vjetor;

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- Shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- Kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- Verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

**Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit:**

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Regjistrimet kontabël nuk mbahen në programe financiare por në Excel dhe më pas hidhen me veprim ekstra-kontabël.
- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Dokumentet vërtetues si urdhër-pagesa, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si kërkesat për financim për veprimet ekonomike të kryera nga drejtoritë përkatëse të miratuar sipas shkallës së hierarkisë, detyrave e përgjegjësisë, duke argumentuar shkakun e veprimit të shoqëruar me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur

këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listë pagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

**Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare:**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë Memaliaj për aktivitetin ekonomiko-financiar **për periudhën 01.01.2024, deri më datën 31.12.2024.**

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës. Gjatë fazës së auditimit në terren u kryhen teste të detajeve dhe testeve thelbësore ku është konstatuar se, janë mbajtur tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2024 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2023. Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2024 konstatohet se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kundrojnë me formatet anekse pjesë e pasqyrave financiare si dhe llogaritë sintetike kuandrojnë me ato analitike.

**Llogaritja e nivelit të materialitetit për të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2024:**

<b>Bashkia Memaliaj 2024, Materialiteti për shpenzimet</b>			
<b>Emërtimi i Shpenzimeve</b>	<b>Vlera e Popullatës</b>	<b>Faktori i Riskut (0.7-2-3)</b>	<b>Çështje për t'u shqyrtuar</b>
Paga (600)	124,526	0.70	10
Sigurime Shoqërore (601)	18,227	0.70	1
Mallra e Shërbime (602)	35,308	0.70	3
Investime të brendshme (230-231)	237,071	2.00	52
Të tjera transferime korrente (606)	148,695	0.70	11
<b>Total</b>	<b>563,827</b>		
Materialiteti në %	2%		
<b>Materialiteti në vlerë</b>	<b>11,277</b>		
Kalkulimi i precizionit			
<b>Materialiteti</b>	<b>11,277</b>		
Gabimi i lejuar (10%-20%)	1,128		
<b>Nëntotali</b>	<b>10,149</b>		
Precizioni i planifikuar (80-90%)	90%		
<b>Vlera e precizionit</b>	<b>9,134</b>		
<b>Bashkia Memaliaj 2024, Materialiteti për të ardhurat</b>			
<b>Emërtimi i të ardhurave</b>	<b>Vlera e Popullatës</b>	<b>Faktori i Riskut (0.7-2-3)</b>	<b>Çështje për t'u shqyrtuar</b>
Të ardhurat nga buxheti	0	0.70	0
Të ardhurat e veta	28,625	0.70	43
<b>Total</b>	<b>28,625</b>		
Materialiteti në %	2%		
<b>Materialiteti</b>	<b>573</b>		
Kalkulimi i precizionit			
<b>Materialiteti</b>	<b>573</b>		
Gabimi i lejuar (10%-20%)	57		
<b>Nëntotali</b>	<b>515</b>		
Precizioni i planifikuar (80 -90%)	90%		
<b>Vlera e precizionit</b>	<b>464</b>		

**Procesi i inventarizimit:**

Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 11, pika 4, dhe Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, neni 74, parashikohet se çdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe dokumentacionit mbështetës. Auditimi i procesit të inventarizimit është kryer duke u bazuar

në gjendjen e aktiveve, shtesat, pakësimet apo nxjerrjen jashtë përdorimit të evidentuara në Pasqyrën nr. 7/a, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike)”, Pasqyrën nr. 7/b, “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)”, kartelat sipas personave të cilën kanë aktive në përdorim, urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit, vlerësimit, asgjesimit, relacionet dhe raportet për gjendjen e inventarit pas përfundimit të procesit të inventarizimit, procedurat për nxjerrjen e aktiveve jashtë përdorimit, fletë-hyrjeve dhe fletë-dajet nga magazina etj. Me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 167, datë 16.10.2024, me objekt “Për kryerjen e inventarit të vlerave materiale monetare”, konkretisht:

1. Kryerjen e inventarizimit të vlerave materiale në institucionet që mbulohen nga Bashkia Memaliaj si më poshtë:

- Në shkollën e mesme “Sali Nivica”;
- Në shkollën 9 vjeçare “Nimete Progonati”;
- Në kopshtin e fëmijëve;
- Në pallatin e kulturës;
- Në administratën e bashkisë;
- Njësia Administrative Memaliaj Fshat, Shkollat, Kopshtet, Ambulanca etj.

2. Për kryerjen e inventarizimit të materialeve të institucioneve të mësipërme është ngritur grupi i punës i përbërë nga: z. M.D. kryetar dhe anëtarët znj. L.C., z. O.C., z. E.H., z. A.D.

3. Kryerjen e inventarizimit të vlerave materiale në institucionet që mbulohen nga Njësiti Administrative si më poshtë:

- Njësia Administrative Lutfinjë, Shkollat, Kopshtet, Ambulanca etj.;
- Njësia Administrative Qesarat, Shkollat, Kopshtet, Ambulanca etj.;
- Njësia Administrative Krahës, Shkollat, Kopshtet, Ambulanca etj.;
- Njësia Administrative Buz, Shkollat, Kopshtet, Ambulanca etj.;

4. Për kryerjen e inventarizimit të materialeve të institucioneve të mësipërme është ngritur grupi i punës i përbërë nga: z. M.D. kryetar dhe anëtarët znj. L.C., z. O.C., z. E.H., z. A.D..

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se, pas përfundimit të procesit të inventarizimit nga komisioni i inventarizimit është hartuar raporti për inventarin fizik, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara ku së bashku me të gjithë dokumentacionin e inventarizimit t’i dorëzohej Nëpunësit Autorizues të institucionit por pa datë dhe pa numër protokolli.

Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore të vitit 2024, të pozicionit financiar të Bashkisë Memaliaj, formati nr. 1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme. Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivitetit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2024, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si më poshtë:

<b>Lekë</b>	
<b>Aktivet Neto janë të barabarta me Aktivet - Pasive = Aktivet Neto</b>	<b>1,112,834,685</b>
Aktivet	1,214,238,244
Pasivet	101,403,559
Aktivet Neto	1,112,834,685

<b>Lekë</b>	
<b>Aktivet Afatshkurtra më datë 31.12.2024</b>	<b>177,321,105</b>
Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre”	94,962,508
Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”	7,407,540
Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”	74,951,057

## A. AKTIVET

### I. Aktivet Afat Shkurtra

#### 1. Llogaritë e klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhen nga:

Lekë

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Diferenca/Ndryshimi 2024-2023
531	Mjete monetare në arkë	0	0	0
512,56	Mjete monetare në bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	68,510,006	52,437,297	16,072,709
50	Letra me vlerë	357,603	610,860	(253,257)
532	Vlera të tjera	26,094,899	14,528,983	11,565,916
54	Akreditiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provizjone zhvlerësimi letra me vlerë (-)	0	0	0
	<b>Totali</b>	<b>94,962,508</b>	<b>67,577,140</b>	<b>27,385,368</b>

- **Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”** paraqitet më datë 01.01.2024, në vlerën 52,437,297 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 68,510,006 lekë. Kjo llogari nuk kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 68,510,006 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 26,094,899 lekë. Llogaria “Disponibilitete në thesar” është nënvlerësuar në vlerën 26,094,899 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pikat 49-50.

- **Llogaria 50 “Letra me vlerë”** më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 610,860 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 357,603 lekë me një pakësim në vlerën 253,257 lekë në të cilën janë të përfshira pullat e Gjendjes Civile dhe biletat e tregut. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 50 “Letra me vlerë”	
Çelje e vitit 2024	610,860
Shtesa (K)	383,000
Pakësime (D)	636,257
<b>Gjendja debitore në 31.12.2024</b>	<b>357,603</b>

- **Llogaria 532 “Vlera të tjera”** më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 14,528,983 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 26,094,899 lekë me një rritje në vlerën 11,565,916 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 532 “Vlera të tjera”	
Çelje e vitit 2024	14,528,983
Shtesa (K)	11,565,916
Pakësime (D)	0
<b>Gjendja debitore në 31.12.2024</b>	<b>26,094,899</b>

Lekë

Vlera të tjera	Gjendja 01.01.2024	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2024
5% garanci punimesh (vlera në ruajtje)	14,528,983	11,565,916	0	26,094,899
<b>Totali</b>	<b>14,528,983</b>	<b>11,565,916</b>	<b>0</b>	<b>26,094,899</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Memaliaj.

Në gjendjen e llogarisë 532 “Vlera të tjera” është përfshirë vlera prej 26,094,899 lekë që i përket 5% të garancive të punimeve si veprim kundërpatrie e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”. Ndërkohë që shumatorja e llogarive 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” dhe 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të kuadrojë me mbylljen e gjendjes së llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”. Në llogarinë 532 “Vlera të tjera” kontabilizohen mjetet që ruhen në arkë në formën e pullave tatimore, pullave postare, bileta apo vlerave të tjera. Këto veprime janë

në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pikat 3.2-3.3.

## 2. Llogaritë e klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Lekë				
Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Diferenca/Ndryshimi 2024-2023
31	Materiale	0	0	0
32	Inventar i imët	7,407,540	6,648,638	758,902
33	Prodhime, punime e shërbime në proces	0	0	0
34	Produkte	0	0	0
35	Mallra	0	0	0
36	Kafshë në rritje e majmëri	0	0	0
37	Gjendje të pambrojtura ose pranë të tretëve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Provizjone për zhvlerësimin e inventarit (-)	0	0	0
<b>Totali</b>		<b>7,407,540</b>	<b>6,648,638</b>	<b>758,902</b>

Llogaritë e klasës 3, sipas pasqyrës së pozicionit financiar në datën 31.12.2024, paraqitet në vlerën 7,407,540 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” 7,407,540 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 758,902 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi i gjendjes së inventarit” e cila paraqitet në vlerën 758,902 lekë, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 4.1.

- **Llogaria 32 “Inventarë i imët”**, ka vlerën 7,407,540 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë		Vlera	Lekë
Çelje e vitit 2024			6,648,638
Shtesa (K)			101,158,812
Pakësime (D)			100,399,910
<b>Gjendja në 31.12.2024</b>			<b>7,407,540</b>

## 3. Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

Lekë				
Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2024	Diferenca/Ndryshimi 2024-2023
	Llogari të arkëtueshme			
411	Klientë e llogari të ngjashme	48,437,125	39,991,494	8,445,631
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	11,181,933	8,481,276	2,700,657
431	Tatime e taksa	900,979	459,023	441,956
432	Tatime mbledhur nga shteti për llogari Pushtetit Lokal	0	0	0
433	Fatkeqësi natyrore që mbulon shteti	0	0	0
435	Sigurime Shoqërore	0	0	0
436	Sigurime Shëndetësore	1,971,655	1,491,037	480,618
437,438	Organizma të tjerë shoqërore	0	0	0
44	Institucione të tjera publike	0	0	0
465	Efekte për t'u arkëtuar nga shitja letra me vlerë vendosjes	0	0	0
468	Debitorë të ndryshëm	0	0	0
4342	Operacione me shtetin (Të drejta)	944,650	783,012	161,638
45	Marrëdhënie me institucione brenda dhe jashtë sistemit	0	0	0
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0
<b>Totali</b>		<b>63,436,351</b>	<b>51,205,842</b>	<b>12,230,509</b>
	Të tjera aktive afatshkurtra			
409	Parapagime	0	0	0
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0	0	0
477	Diferenca konvertimi aktive	0	0	0
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0	0	0

486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	11,514,715	50,984,742	(39,470,027)
<b>Totali</b>		<b>11,514,715</b>	<b>50,984,742</b>	<b>(39,470,027)</b>

- Gjendja e llogarisë 411 “Klientë e llogari të ngjashme” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 39,991,494 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 48,437,125 lekë me një rritje në vlerën 8,445,631 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 411 “Klientë e llogari te ngjashme”		Lekë
Çelje e vitit 2024		39,991,494
Shtesa (K)		18,086,204
Pakësime (D)		9,640,573
<b>Gjendja debitore në 31.12.2024</b>		<b>48,437,125</b>

Klientë e llogari te ngjashme	Gjendja 01.01.2024	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2024
Njësitë administrative	19,718,693		366,500	19,352,193
Biznesi i vogël	1,434,861	2,656,455	1,196,048	2,895,268
Biznesi i madh (Qytet Memaliaj)	456,587	1,150,277	949,809	657,055
Toka me qira, pyje kullota	4,440,554	1,552,560	903,029	5,090,085
Objekte me qira	280,300	250,000	191,000	339,300
Taks ndertese, taksë trualli	3,346,797	1,452,000	1,021,000	3,777,797
Toka bujqësore	10,203,702	10,737,774	4,715,452	16,226,024
Instuticione	110,000	252,353	272,600	89,753
Shërbim taksi	0	34,785	25,135	9,650
<b>Totali</b>	<b>39,991,494</b>	<b>18,086,204</b>	<b>9,640,573</b>	<b>48,437,125</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Memaliaj.

Në gjendjen e llogarisë 411 “Klientë e llogari të ngjashme” është kontabilizuar vlera 48,437,125 lekë që i përket debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore dhe përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, vlerë e cila duhej të kontabilizohej në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”. Referuar trajtimit kontabël në llogarinë 411 “Klientë e llogari të ngjashme” kontabilizohen të ardhura nga mallrat apo shërbimi me arkëtim të mëvonshëm. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 4.2, pika 5, dhe Kapitulli II, seksioni 2.2.

- Gjendja e llogarisë 423,429 “Personeli, paradhënie, defiçite, gjoba” më datë 01.01.2023, paraqitet në vlerën 8,481,276 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 11,181,933 lekë me një rritje në vlerën 2,700,657 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 423,429 “Personeli, paradhënie, defiçite, gjoba”		Lekë
Çelje e vitit 2024		8,481,276
Shtesa (K)		2,700,657
Pakësime (D)		0
<b>Gjendja debitore në 31.12.2024</b>		<b>11,181,933</b>

Personeli, paradhënie, defiçite, gjoba	Gjendja 01.01.2024	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2024
Personeli rritje e nivelit të pagave	8,481,276	2,700,657	0	11,181,933
<b>Totali</b>	<b>8,481,276</b>	<b>2,700,657</b>	<b>0</b>	<b>11,181,933</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Memaliaj.

- Gjendja e llogarisë 431 “Tatim e taksa” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 459,023 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 900,979 lekë me një rritje në vlerën 441,956 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 431 "Tatim e taksa"		Lekë
Çelje e vitit 2024		459,023
Shtesa (K)		441,956
Pakësime (D)		0
<b>Gjendja debitore në 31.12.2024</b>		<b>900,979</b>

Tatim e taksa	Gjendja 01.01.2024	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2024
Rritja e nivelit të pagave	459,023	441,956	0	900,979
<b>Totali</b>	<b>459,023</b>	<b>441,956</b>	<b>0</b>	<b>900,979</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Memaliaj.

- Gjendja e **llogarisë 436 "Sigurime shëndetësore"** më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 1,491,037 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 1,971,655 lekë me një rritje në vlerën 480,618 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 431 "Tatim e taksa"		Lekë
Çelje e vitit 2024		1,491,037
Shtesa (K)		480,618
Pakësime (D)		0
<b>Gjendja debitore në 31.12.2024</b>		<b>1,971,655</b>

Personeli, paradhënie, defiqite, gjoba	Gjendja 01.01.2024	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2024
Rritja e nivelit të pagave	1,491,037	480,618	0	1,971,655
<b>Totali</b>	<b>1,491,037</b>	<b>480,618</b>	<b>0</b>	<b>1,971,655</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Memaliaj.

Në llogaritë 423,429 "Personeli, paradhënie, defiqite, gjoba", 431 "Tatim e taksa" dhe 436 "Sigurime shëndetësore" është kontabilizuar vlera totale prej 14,054,567 lekë në Aktiv, si kundërpartit e Pasivit për detyrimet të cilat i përkasin muajt dhjetor të vitit ushtrimor që likuidohen në muaj janar të vitit pasardhës, ndërkohë që si veprim kontabël duhej të kryej në llogarinë 4342 "Operacion me shtetin (të drejta)".

- Gjendja e **llogarisë 4342 "Operacion me shtetin (të drejta)"** më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 783,012 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 944,650 lekë me një rritje në vlerën 161,638 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria 4342 "Operacione me shtetin (të drejta)		Lekë
Çelje e vitit 2024		783,012
Shtesa (K)		161,638
Pakësime (D)		0
<b>Gjendja debitore në 31.12.2024</b>		<b>944,650</b>

Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, përmbledhsja e llogarive 401-408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" paraqitet në vlerën 48,437,125 lekë, 42 "Detyrime ndaj personelit" në vlerën 11,181,933 lekë, 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa" në vlerën 900,979 lekë, 435 "Sigurime shoqërore" në vlerën 1,971,655 lekë, 464 "Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë" në vlerën 357,603 lekë dhe 467 "Kreditorë të ndryshëm" në vlerën 11,514,715 lekë ku totali shkon në vlerën 74,364,010 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 "Operacione me shtetin (Të drejta)" në vlerën 944,650 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Aneksi 1.

- **Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”** më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 50,984,742 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 11,514,715 lekë me një pakësim në vlerën 39,470,027 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llekë	
<b>Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”</b>	
Çelje e vitit 2024	50,984,742
Shtesa (K)	5,194,212
Pakësime (D)	56,179,224
<b>Gjendja debitore në 31.12.2024</b>	<b>11,514,715</b>

Llekë				
Shpenzime të periudhave të ardhshme	Gjendja 01.01.2024	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2024
Kreditorët	50,984,742	5,194,212	56,179,224	11,514,715
<b>Totali</b>	<b>50,984,742</b>	<b>5,194,212</b>	<b>56,179,224</b>	<b>11,514,715</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Memaliaj.

Nga auditimi konstatohet se llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” është paraqitur në vlerën 11,514,715 lekë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Seksioni 3.1, pika 15, për arsye se kjo vlerë duhej të kontabilizohet në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

Llogaritë e klasës 4, kanë funksionuar duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

## II. AKTIVET AFAT GJATA

Llogaritë e klasës 20 “Aktive afatgjata jo materiale”, 21 “Aktive afatgjata materiale”, 25-26 “Aktive afatgjata financiare” dhe 23 “Investime në proces” përbëhen nga:

Llekë				
Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	31.12.2024	31.12.2023	Diferenca/Ndryshimi 2024-2023
	<b>II. Aktive Afatgjata</b>	<b>1,036,917,139</b>	<b>892,551,136</b>	<b>144,366,003</b>
<b>20</b>	<b>1. Aktive Afatgjata jo materiale</b>	<b>3,945,960</b>	<b>3,945,960</b>	<b>0</b>
201	Prime të emisionit dhe rimbursimit të huave	0	0	0
202	Studime dhe kërkime	3,945,960	3,945,960	0
203	Koncesione, Patenta, Licensa e të ngjashme	0	0	0
<b>21</b>	<b>2. Aktive Afatgjata materiale</b>	<b>1,032,971,179</b>	<b>888,605,176</b>	<b>144,366,003</b>
210	Toka, Troje, Terene	119,998	119,998	0
211	Pyje, Plantacione	277,000	277,000	0
212	Ndërtesa e konstruksione	385,906,244	319,562,526	66,343,718
213	Rrugë, rrjete, vepra ujore	635,626,002	542,276,780	93,349,222
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	4,670,852	5,340,098	-669,246
215	Mjete transporti	1,314,529	6,774,529	-5,460,000
216	Rezerva shtetërore	0	0	0
217	Kafshë pune e prodhimi	0	0	0
218	Inventar ekonomik	5,056,554	14,254,245	-9,197,691
24	Aktive afatgjata të dëmtuara	0	0	0
28	Caktime të aktiveve afatgjata	0	0	0
<b>25-26</b>	<b>3. Aktive Afatgjata Financiare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
25	Huadhënie e nën-huadhënie	0	0	0
26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet	0	0	0
	<b>4. Investime</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
230	Për Aktive Afatgjata jo materiale	0	0	0
231	Për Aktive Afatgjata materiale	0	0	0

### 1. Aktivët Afatgjatë Jomateriale.

- **Llogaria 202 “Studime dhe kërkime”** më datë 01.01.2024, ka qenë në vlerën 3,945,960 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 2,070,440 lekë dhe pakësime në vlerën

2,070,440 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 3,945,960 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

		Lekë	
Referenca	Nr.	Llogaria 202 "Studime dhe kërkime"	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	3,945,960
	2	Amortizim i akumuluar	0
	3	<b>Gjendja në 01.01.2024</b>	<b>3,945,960</b>
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	2,070,440
	5	Amortizim i shtesës	0
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	2,070,440
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	3,945,960
	5	Amortizim i akumuluar	0
	6	<b>Gjendja më datë 31.12.2024</b>	<b>3,945,960</b>

Vlera e mbetur në fund të vitit 2024, prej 3,911,473 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 "Studime dhe kërkime", për 20 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Gjithashtu për këto aktive nuk është llogaritur amortizimi në masën 15% të vlerës së mbetur. Këto veprime janë në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, "Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale" i përmirësuar, pikat 66-69, VKM nr. 783, datë 22.11.2006, "Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël", Seksioni II "Aktivet e Qëndrueshme Patrupëzuar" pika 1/b "Klasifikimi kontabël" e cila ndër të tjera përcakton se: "Shpenzimet e kërkimeve të aplikuara dhe të zhvillimit - Llogaria 202" "Studime dhe Kërkime", Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75, dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, Kreu II "Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes së kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik" pika 2, klasa 2, "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël), pika 5 dhe gërma "d", pika 36, "Për aktive afatgjata jo materiale, amortizimit të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimit 15%".

## 2. Aktivet Afatgjata Materiale

-**Llogaria 210 "Toka, troje, terrene"** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 119,998 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime ndërsa më datë 31.12.2023, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 119,998 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

		Lekë	
Referenca	Nr.	Llogaria 210 "Toka, troje, terrene" Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	119,998
	2	Amortizim i akumuluar	0
	3	<b>Gjendja në 01.01.2024</b>	<b>119,998</b>
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	0
	5	Amortizim i shtesës	0
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	119,998
	5	Amortizim i akumuluar	0
	6	<b>Gjendja më datë 31.12.2024</b>	<b>119,998</b>

- **Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 277,000 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 277,000 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Referenca	Nr.	Llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	277,000
	2	Amortizim i akumuluar	0
	3	<b>Gjendja në 01.01.2024</b>	<b>277,000</b>
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	0
	5	Amortizim i shtesës	0
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	277,000
	5	Amortizim i akumuluar	0
6	<b>Gjendja më datë 31.12.2024</b>	<b>277,000</b>	

Për sa trajtuar më sipër llogaria 210 “Toka, troje, terrene” e pasqyruar në bilanc për vlerën 119,998 lekë dhe llogaria 211 “Pyje, kullota, plantacione” në vlerën 277,000 lekë janë të paanalizuara, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave për këto llogari. Këto veprime janë në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale”, Kapitulli “Trajtimi Kontabël për Aktivet Afatgjata të Investuara”, pikat 47-54, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30.

- **Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione”** më datë 01.01.2024, ka qenë në vlerën 319,562,526 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 91,087,728 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 200,061,681 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 385,906,244 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (**në Aneksin nr. 1, Tabela nr. 1.**) në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Referenca	Nr.	Llogaria 212 “Ndërtesa e konstruksione” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	494,880,197
	2	Amortizim i akumuluar	175,317,671
	3	<b>Gjendja në 01.01.2024</b>	<b>319,562,526</b>
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	91,087,728
	5	Amortizim i shtesës	24,744,010
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	585,967,925
	5	Amortizim i akumuluar	200,061,681
	6	<b>Gjendja më datë 31.12.2024</b>	<b>385,906,244</b>

- **Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 542,276,780 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 143,226,525 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 505,148,592 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 635,626,002 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (**në Aneksin nr. 1, Tabela nr. 2.**) në pasqyrën si më poshtë:

Lekë			
Referenca	Nr.	Llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	997,546,069
	2	Amortizim i akumuluar	455,269,289
	3	<b>Gjendja në 01.01.2024</b>	<b>542,276,780</b>
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	143,226,525
	5	Amortizim i shtesës	49,877,303
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0

	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	1,140,772,594
	5	Amortizim i akumuluar	505,148,592
	6	<b>Gjendja më datë 31.12.2024</b>	<b>635,626,002</b>

- **Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 5,340,098 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 897,240 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 11,891,248 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 4,670,852 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

<b>Lekë</b>			
Referenca	Nr.	Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	15,664,860
	2	Amortizim i akumuluar	10,324,762
	3	<b>Gjendja në 01.01.2024</b>	<b>5,340,098</b>
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	897,240
	5	Amortizim i shtesës	1,566,486
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	16,562,100
	5	Amortizim i akumuluar	11,891,248
	6	<b>Gjendja më datë 31.12.2024</b>	<b>4,670,852</b>

- **Llogaria 215 “Mjete transporti”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 6,774,529 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 1,860,000 lekë, pakësime në vlerën 7,320,000 lekë dhe amortizim të akumuluar në vlerën 12,179,821 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 1,314,529 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

<b>Lekë</b>			
Referenca	Nr.	Llogaria 215 “Mjete transporti” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	18,854,350
	2	Amortizim i akumuluar	12,179,821
	3	<b>Gjendja në 01.01.2024</b>	<b>6,774,529</b>
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	1,860,000
	5	Amortizim i shtesës	0
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	7,320,000
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	13,494,350
	5	Amortizim i akumuluar	12,179,821
	6	<b>Gjendja më datë 31.12.2024</b>	<b>1,314,529</b>

<b>Lekë</b>					
Mjete transporti (kosto historike)		Gjendja	Shtesa	Pakësime	Gjendja
Objekte inventari		01.01.2024	(D)	(K)	31.12.2024
Mjete transporti (jashtë Përdorimit)		3,312,750			3,312,750
Mjete transporti (Në gjendje pune)		15,641,600	1,860,000	7,320,000	10,181,600
<b>Totali</b>		<b>18,954,350</b>	<b>1,860,000</b>	<b>7,320,000</b>	<b>13,494,350</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Memaliaj.

- Për llogarinë 215 “Mjete transporti” në pasqyrat financiare është kontabilizuar vlera 13,494,350 lekë. Në këtë vlerë është përfshirë edhe vlera e automjeteve të dëmtuara me vlerë kosto historike 3,312,750 lekë të cilat nuk janë në gjendje pune të konstatuara si të tilla në procesin e inventarizimit. Në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi nr. 1, “Analiza, përbërja sipas klasave dhe trajtimi kontabël i llogarive të kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme (NJQP)”, 2.1, “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të klasës 2”, vlera 3,312,750 lekë e cila i përket koston historike mjete të dëmtuara duhej

të debitohej në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”. Pra nga llogaria 215 “Mjete transporti”, duhet të zbritet vlera e automjeteve të dëmtuara dhe të regjistrohet në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”.

- Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)” deri më datë 31.12.2023, për llogarinë 215 “Mjete transporti” është përlllogaritur amortizim i akumuluar në vlerën 12,179,821 lekë por nuk është përlllogaritur amortizim vjetor. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 36.

- **Llogaria 218 “Inventar ekonomik”** më datën 01.01.2024, ka qenë në vlerën 14,254,245 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari nuk ka pasur shtesa apo pakësime dhe amortizim të akumuluar në vlerën 40,931,901 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 5,056,554 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

		Lekë	
Referenca	Nr.	Llogaria 218 “Inventar ekonomik” Objekte inventari	
Ditari i veprimeve	1	Kosto historike	45,988,455
	2	Amortizim i akumuluar	31,734,210
	3	<b>Gjendja në 01.01.2024</b>	<b>14,254,245</b>
	4	Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	0
	5	Amortizim i shtesës	9,197,691
	6	Pakësime gjatë vitit 2024 (K)	0
	7	Amortizim nga pakësimet	0
	4	Kosto historike	45,988,455
	5	Amortizim i akumuluar	40,931,901
	6	<b>Gjendja më datë 31.12.2024</b>	<b>5,056,554</b>

- Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto)” për llogarinë 218 “Inventar ekonomik” është përlllogaritur normë amortizimi i akumuluar deri më datë 31.12.2024, në vlerën 40,931,901 lekë (kosto historike) ose në masën 20%. Ndërkohë që nuk ka një ndarje të llogarisë 218/6 “Pajisje kompjuterike” nga aktivet e llogarisë bazë 218 “Inventar ekonomik” e cila ka normë amortizimi të aplikueshme në masën 25%. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 36.

- Nga auditimi i **llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”**, u konstatua se kjo llogari është nënvlerësuar në vlerën 322,000 lekë. Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare Ujësjiellës Kanalizime Memaliaj me Nipt M09831502C është 159,000,000 lekë e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastër me Nipt M23329601L. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Memaliaj është 322,000 ose 3.22% ( $3.22 \cdot 10,000,000 / 100 = 322,000$  lekë). Ndërkohë që llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 0 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale” i përmirësuar, pikat 55-57, Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14, “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”, pikat 27-30, dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar.

#### 4. Invenstimet

Gjendja e llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve konstatohet se,

për vitin 2024 ka kontrata që nuk kanë përfunduar si punime dhe likuidimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit konkretisht, “Rikonstruksioni i shkarjeve të rrugëve të Njërive Administrative Buz-Lutfinjë” në vlerën 20,675,896 lekë; “Skema ujitëse vaditëse “Kanali ujitës” Krahës” në vlerën 7,224,000 lekë; “Rikonstruksioni i Gjimnazit dhe ambienteve sportive “Sali Nivica” në vlerën 53,557,000 lekë; “Ndërtimi i Ujësjellësit Rajonal për fshatrat Vasjar, Iliras, Qësarat, Anë Vjosë, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahës dhe Qytetin Memaliaj” në vlerën 179,028,083 lekë dhe “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara, Bashkia Memaliaj” në vlerën 30,934,440 lekë. Vlera prej 291,419,419 lekë e kontratave të sipërpërmendura duhet të ishte pjesë e gjendjes së llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” dhe jo pjesë e gjendjes së llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore” siç ka ndodhur në fakt, pasi ky aktiv nuk është kapitalizuar në vlerë të plotë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1, Klasa 23.

- Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, llogaria 230 “Investime për aktive afatgjata jo materiale” paraqiten në vlerën 0 lekë dhe llogaria 231 “Investime për aktive afatgjata materiale” në vlerën 0 lekë ku totali i tyre shkon në vlerë 0 lekë i cili kuadron me totalin e llogarisë 115 “Nga fondet e veta të investimeve” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë dhe llogarinë 105 “Teprica e granteve kapitale të brendshme” në vlerën 0 lekë, në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, Aneksi 1, gërma “c”.

Nga auditimi konstatohet se, asetet e kaluara nga Pushteti Qendror pranë Bashkisë Memaliaj paraqitet sipas VKM-ve si më poshtë:

- Për **Bashkinë Memaliaj** (Bashkia Qendër) është miratuar lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë transferuar në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Memaliaj, me VKM nr. 974, datë 30.09.2009, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Memaliaj të Qarkut të Gjirokastrës”, sipas lidhjes nr. 1, me 45 (dyzetë e pesë) fletë dhe përmbajtje 263 prona.

- Për **Ish-Komunën Qesarat** është miratuar lista e inventarit paraprak me VKM nr. 417, datë 09.06.2005, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Qesarat, Qarku Gjirokastrë”. Lista e inventarit me 55 (pesëdhjetë e pesë) fletë përfundon me numrin rendor 353. Ne vijim është miratuar lista përfundimtare e inventarit me VKM nr. 341, datë 12.05.2010, “Për miratimin e listës përfundimtare të inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Komunën Qesarat, Qarku Gjirokastrë”.

- Për **Ish-Komunën Krahës** është miratuar lista e inventarit me VKM nr. 657, datë 21.05.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Krahës, të qarkut të Gjirokastrës”. Lista e inventarit me 2 (dy) fletë përfundon me numrin rendor 28.

- Për **Ish-Komunën Buz** është miratuar lista e inventarit me VKM nr. 663, datë 28.09.2011, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Buz të Qarkut të Gjirokastrës”. Lista e inventarit me 93 (nëntëdhjetë e tre) fletë, përfundon me numër rendor 667.

- Për **Ish-Komunën Luftinjë** është miratuar lista e inventarit me VKM nr. 790, datë 16.11.2006, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në Komunën Luftinjë, të Qarkut të Gjirokastrës”. Lista e inventarit me 122 (njëqind e njëzetë e dy) fletë, përfundon me numër rendor 865.

- Për **Ish-Komunën Fshat Memaliaj** është miratuar lista e inventarit me VKM nr. 1239, datë 10.09.2008, “Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Memaliaj Fshat, të qarkut të Gjirokastrës. Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ, të komunës Memaliaj Fshat, të qarkut të Gjirokastrës, miratuar me Vendimin nr. 5, datë 07.01.2005, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Fushë-Memaliaj, të qarkut të Gjirokastrës”.

Nga auditimi rezulton se referuar inventarit të aseteve, Bashkia Memaliaj zotëron në total 3,293 asete, nga të cilat për 2,028 raste është miratuar lista përfundimtare, ndërkohë pjesa e mbetur janë në fazë paraprake. Të dhënat paraqiten në mënyrë analitike **në Aneksin nr. 1, Tabela nr. 3.)**

Referuar listave të miratuara të inventareve si më lart, Bashkia Memaliaj zotëron **në total 3,293 prona**. Deri më datë 31.12.2024, në total janë pajisur me çertifikatë pronësie 3 prona dhe 3 prona janë proces çertifikimi, për të cilat të dhënat paraqiten si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i pronës	Nr. i pasurisë	Data e regjistrimit	ZK	Adresa	Sipërfaqe truall m <sup>2</sup>	Sipërfaqe ndërtimi m <sup>2</sup>	Pasqyruar ose jo në bilancin e bashkisë
1	Tokë Truall + Ndërtesë Qendra Shëndetësore Memaliaj Godinë 3 kateshe dhe Lavanderi Godine Një Katëshe	5/456	06.06.2016	2646	Lagja nr. 1 Qytet Memaliaj	793.8	569.6	-
2	Tokë Truall (Shesh Funkcional)	5/305	06.06.2016	2646	Qytet Memaliaj	1,079	-	-
3	Ambiente bosh ish-zyrave të punës dhe ish-zyrave të Bashkisë Memaliaj	5/310+1-1	28.10.2020	2646	Qytet Memaliaj	189	189	-

Burimi i të dhënave: Bashkia Memaliaj.

- Për aktivet që i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, Bashkia Memaliaj **të cilat janë të evidentuara në kontabilitet vetëm 3 prej tyre janë të pajisura me çertifikatë pronësie**. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35, gërma “a”, “b” dhe “c” për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur ligjor. Nga Bashkia Memaliaj nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura sipas llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” Kreu IV neni 37 pika 1, 2, gërmat “a-b”, Ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 35-41, VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30.

## **B. PASIVET (DETYRIMET)**

### **I. Pasivet Afatshkurtra**

#### **1. Llogari të pagueshme**

Llogaritë e Klasës 4 në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Memaliaj më datën 31.12.2024, kundrejt furnitorëve, pagat e

punonjësve, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2024, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj. Të dhënat në mënyrë analitike paraqiten si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi i llogarisë	Viti 2024	Viti 2023	Diferenca/Ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to	48,437,125	39,991,494	8,455,631
42	Detyrime ndaj personelit	11,181,933	8,481,276	2,700,657
16,17,18	Hua afat shkurtër	0	0	0
460	Huadhënës	0	0	0
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	900,979	459,023	441,956
432	Tatime, mbledhur për llogari të pushtetit lokal	0	0	0
433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore	0	0	0
435	Sigurime shoqërore	1,971,655	1,491,037	480,618
436	Sigurime shëndetësore	0	0	0
437,438	Organizma të tjerë shtetërore	0	0	0
44	Institucione të tjera publike	0	0	0
45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësisve ekonomike	0	0	0
464	Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë	357,603	610,860	(253,257)
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	26,094,899	14,528,983	11,565,916
467	Kreditorë të ndryshëm	11,514,715	50,984,742	(39,470,027)
4341	Operacione me shtetin (detyrime)	944,650	783,012	161,638
49	Shuma të parashikuara për zhvlerësim (-)	0	0	0
<b>Gjendje në fund të periudhës</b>		<b>101,403,559</b>	<b>117,330,427</b>	<b>(15,926,868)</b>

- **Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”** më datë 01.01.2024, është në vlerën 39,991,494 lekë në të cilën duhet të paraqiten faturat e pa likuiduara nga Bashkia Memaliaj. Gjatë vitit 2024 ka pasur shtesa në vlerën 18,086,204 lekë dhe pakësime në vlerën 9,640,573 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 48,437,125 lekë. Lëvizja e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, paraqitet **(në Aneksin nr. 1, Tabela nr. 4.)** në tabelat si më poshtë:

Lekë

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”	
Çelje e vitit 2024	39,991,494
Shtesa (K)	18,086,204
Pakësime (D)	9,640,573
<b>Gjendja debitore në 31.12.2024</b>	<b>48,437,125</b>

Në gjendjen e llogarisë 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” është përfshirë vlera prej 48,437,125 lekë që i përket debitorëve nga taksat dhe tarifatat vendore të cilat duhej të kontabilizoheshin në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 3.3, “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4)”.

- **Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”** referuar pasqyrave financiare vlera 11,181,933 lekë përfaqëson vlerën e pagave për muajin dhjetor të vitit 2024 e cila mbetet për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

Lekë

Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit”	
Çelje e vitit 2024	8,481,276
Shtesa (K)	11,181,933
Pakësime (D)	8,481,276
<b>Gjendja debitore në 31.12.2024</b>	<b>11,181,933</b>

Lekë

Urdhër shpenzimi		Vlera
Nr.	Datë	
1	03.01.2024	262,951
2	03.01.2024	2,968,816

3	03.01.2024		479,612
4	04.01.2024		2,969,783
5	04.01.2024		737,685
6	08.17.2024		1,062,429
<b>Totali</b>			<b>11,181,933</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Memaliaj.

- **Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”**, paraqitet në vlerën 900,979 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime nga Shtetit për muajin dhjetor. Likuidimi i tyre paraqitet sipas dokumenteve të Thesarit të muajit Janar të vitit 2025, si më poshtë:

<b>Llogaria 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”</b>		<b>Lekë</b>
Çelje e vitit 2024		459,023
Shtesa (K)		900,023
Pakësime (D)		459,023
<b>Gjendja debitoare në 31.12.2024</b>		<b>900,979</b>

<b>Urdhër shpenzimi</b>		<b>Vlera</b>	
<b>Nr.</b>	<b>Datë</b>		
10	17.01.2024		900,979
<b>Totali</b>			<b>900,979</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Memaliaj.

- **Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”** paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2024 që paguhet në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 1,971,655 lekë.

<b>Llogaria 435 “Sigurime shoqërore”</b>		<b>Lekë</b>
Çelje e vitit 2024		1,491,037
Shtesa (K)		1,971,655
Pakësime (D)		1,491,037
<b>Gjendja debitoare në 31.12.2024</b>		<b>1,971,655</b>

<b>Urdhër shpenzimi</b>		<b>Vlera</b>	
<b>Nr.</b>	<b>Datë</b>		
6	17.01.2024		61,155
7	17.01.2024		885,028
8	17.01.2024		241,358
9	17.01.2024		303,496
<b>Totali</b>			<b>1,971,655</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Memaliaj.

- Nga auditimi konstatohet se në gjendjen e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore” është kontabilizuar edhe detyrimet që i përkasim detyrimeve shëndetësore të muajit dhjetor që mbeten për t’u likuiduar në muajin janar të vitit pasardhës, ndërkohë që këto detyrime duhej të kontabilizoheshin në llogarinë 436 “Sigurime shëndetësore”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 3.3.

- **Llogaria 464 “Detyrime për t’u paguar për blerjen e letrave me vlerë”** më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 610,860 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 357,603 lekë me një pakësim në vlerën 253,257 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

<b>Llogaria 464 “Detyrime për t’u paguar për blerjen e letrave me vlerë”</b>		<b>Lekë</b>
Çelje e vitit 2024		610,860
Shtesa (K)		383,000
Pakësime (D)		636,257

Gjendja debitore në 31.12.2024	357,603
--------------------------------	---------

Lekë

Detyrime për t'u paguar për blerjen e letrave me vlerë	Gjendja 01.01.2024	Shtesa (D)	Pakësime (K)	Gjendja 31.12.2024
Pulla postare,dhe taksa tregu	610,860	383,000	636,257	357,603
<b>Totali</b>	<b>610,860</b>	<b>383,000</b>	<b>636,257</b>	<b>357,603</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Memaliaj.

Në gjendjen e llogarisë 464 “Detyrime për t'u paguar për blerjen e letrave me vlerë” është përfshirë vlera prej 357,603 lekë e cila i përket disponibilitetit të pullave postare dhe biletave të tregut të cilat duhet të kontabilizoheshin në llogarinë 50 “Letra me vlerë”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 3 “Inventari, llogaritë e të tretëve si dhe llogarive financiare” (Përbërja dhe trajtimi kontabël i klasës 3, 4 dhe 5).

- **Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”** sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Memaliaj në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerë 26,094,899 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Vlera e mësipërme është rakorduar me Degën e Thesarit Tepelenë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në **Aneksin nr. 1, Tabela nr. 5.**) në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”	
Çelje e vitit 2023	14,528,983
Shtesa (K)	0
Pakësime (D)	11,565,916
<b>Gjendja debitore në 31.12.2023</b>	<b>26,094,899</b>

- Për 25 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Memaliaj janë ngurtësuar fonde në vlerën 7,159,788 lekë për të cilat nuk është bërë zhblllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Tepelenë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Financës nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 7,159,788 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Kapitulli III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10.

- **Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”** paraqiten faturat e pa likuiduara për investime dhe shërbime të cilat më datë 01.01.2024, janë në vlerën 50,984,742 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, në vlerën 11,514,715 lekë me një pakësim në vlerën 39,470,027 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet (në **Aneksin nr. 1, Tabela nr. 6.**) në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”	
Çelje e vitit 2023	50,984,742
Shtesa (K)	5,194,212
Pakësime (D)	44,664,509
<b>Gjendja kreditore në 31.12.2023</b>	<b>11,514,715</b>

- **Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”** më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 783,012 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 944,650 lekë me një rritje në vlerën 161,638 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

<b>Lekë</b>	
<b>Llogaria 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)"</b>	
Çelje e vitit 2024	783,012
Shtesa (K)	944,650
Pakësime (D)	783,012
<b>Gjendja debitore në 31.12.2024</b>	<b>944,650</b>

<b>Lekë</b>				
<b>Operacione me shtetin (detyrime)</b>	<b>Gjendja 01.01.2024</b>	<b>Shtesa (D)</b>	<b>Pakësime (K)</b>	<b>Gjendja 31.12.2024</b>
	783,012			783,012
(Pagesa e këshilltarëve, kryetar/fshati, patrimi) muaji dhjetor 2024, pa likuaduar		944,650		944,650
(Pagesa e këshilltarëve, kryetar/fshati, pastrimi) dhjetor 2023) likuaduar gjatë vitit 2024			783,012	783,012
<b>Totali</b>	<b>783,012</b>	<b>944,650</b>	<b>783,012</b>	<b>944,650</b>

Burimi i të dhënave: Bashkia Memaliaj.

<b>Lekë</b>			
<b>Llogaria</b>	<b>Emërtimi</b>	<b>31.12.2024</b>	<b>31.12.2023</b>
<b>C</b>	<b>AKTIVET NETO/FONDET (A-B)</b>	<b>1,112,834,685</b>	<b>951,637,071</b>
<b>D</b>	<b>FONDI I KONSOLIDUAR</b>	<b>1,112,834,685</b>	<b>951,637,071</b>
101	Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	1,044,324,679	899,199,774
12	Rezultatet e mbartura	0	0
85	Rezultati i veprimtarisë ushtrimore	68,510,006	52,437,297
111	Rezerva	0	0
115	Nga fondet e veta të investimeve	0	0
15	Shuma të parashikuara për rreziqe e zhvlerësime	0	0
105	Teprica e granteve kapitale të brendshme	0	0
106	Teprica e granteve kapitale të huaja	0	0
107	Vlera e mjeteve të caktuara për përdorim	0	0
109	Rezerva nga rivlerësimi i aktiveve afatgjata	0	0
	Të tjera	0	0
<b>E</b>	<b>TOTALI I PASIVEVE (B+C)</b>	<b>1,214,238,244</b>	<b>1,068,967,498</b>

<b>Lekë</b>				
<b>Fondi i konoliduar</b>	<b>Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar"</b>			
<b>1,112,834,685</b>	<b>Mbyllje më datë 31.12.2024</b>		<b>Çelje më datë 01.01.2024</b>	
	<b>Debi</b>		<b>Kredi</b>	
			899,199,774	Çelja gjendja e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" i datës 31.12.2023
	9,390,440	Pakësimet me VKN sipas pasqyrës nr. 7/b	239,141,933	Shtesat sipas pasqyrës nr. 7/b.
	85,385,490	Amortizimi i shtesës sipas pasqyrës nr. 7/b	758,902	Llogaria 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit"
<b>Totali</b>	<b>94,775,930</b>		<b>1,139,100,609</b>	
<b>1,139,100,609 – 94,775,930 = 1,044,324,679</b>				
<b>1,044,324,679 - 1,044,324,679 = 0</b>				

Çelja e llogarisë 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 899,199,774 lekë. Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" kreditohet për shtesat e vitit sipas Pasqyrës nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)" në vlerën 239,141,933 lekë dhe për ndryshimin e gjendjes së inventarit në vlerën 758,902 lekë sipas llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit". Llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" debitohet për pakësimet e vitit në vlerën 9,390,440 lekë dhe amortizimin e vitit ushtrimor 2024 në vlerën 85,385,490 lekë sipas gjendjes të evidentuar në Pasqyrën nr. 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)".

Sipas informacionit kontabël llogaria 101 "Teprica (Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar" është kontabilizuar saktë në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018, "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pika 17.

## TË ARDHURAT

### 1. Të ardhurat nga taksat dhe tatimet:

- **Llogaria 70 “Të ardhurat nga taksat e tatimet”**, në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 11,154,162 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 10,328,834 lekë ose me një pakësim në vlerën 825,328 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat nga taksat e tatimet paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
<b>70</b>	<b>I. TË ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIME</b>	<b>10,328,834</b>	<b>11,154,162</b>
<b>700</b>	<b>1. Tatimi mbi të ardhurat</b>	<b>91,499</b>	<b>1779,163</b>
7000	Tatimi mbi të ardhurat personale	0	0
7001	Tatimi mbi fitimin	0	0
7002	Tatim mbi biznesin e vogël	91,499	179,163
7009	Të tjera tatime mbi të ardhurat	0	0
<b>702</b>	<b>2. Tatimi mbi pasurinë</b>	<b>4,598,608</b>	<b>3,074,514</b>
7020	Tatim mbi pasurinë e paluajtshme	4,598,608	3,074,514
7021	Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme	0	0
7029	Të tjera tatime mbi pasurinë	0	0
<b>703</b>	<b>3. Tatime mbi mallrat e shërbimet brenda vendit</b>	<b>5,638,727</b>	<b>7,900,485</b>
7030	Tatim mbi vlerën e shtuar (TVSH)	0	0
7031	Akciza	0	0
7032	Taksë mbi shërbimet specifike	0	0
7033	Taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie	0	0
7035	Taksë vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie	5,638,727	7,900,485
<b>704</b>	<b>4. Taksë mbi tregtinë dhe transaksionet ndërkombëtare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
7040	Taksë doganore për mallrat e importit	0	0
7041	Taksë doganore për mallrat e eksportit	0	0
7042	Tarifë shërbimi doganor e kalipostë	0	0
7049	Të tjera taksë mbi tregtinë e transaksionet ndërkombëtare	0	0
<b>705</b>	<b>5. Taksë e rrugës</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>708</b>	<b>6. Të tjera tatime e taksë kombëtare</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
<b>709</b>	<b>7. Gjoha e kamatë vonesa</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

### 2. Të ardhurat jo tatimore:

- **Llogaria 71 “Të ardhura jo tatimore”**, në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 7,546,798 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 9,136,383 lekë ose me një rritje në vlerën 1,589,585 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë të ardhurat jo tatimore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
<b>71</b>	<b>III. TË ARDHURA JO TATIMORE</b>	<b>9,136,383</b>	<b>7,546,798</b>
<b>710</b>	<b>1. Nga ndërmarrjet dhe pronësia</b>	<b>3,535,265</b>	<b>2,497,389</b>
7100	Nga ndërmarrjet publike jo financiare	0	0
7101	Nga ndërmarrjet publike financiare	0	0
7109	Të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	3,535,265	2,497,389
<b>711</b>	<b>2. Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare</b>	<b>5,601,118</b>	<b>5,049,409</b>
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	4,157,079	3,797,721
7111	Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	1,184,512	871,002
7112	Taksë për veprime gjyqësore e noteriale	0	0
7113	Të ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	85,966	82,695
7114	Të ardhura nga biletat	0	0
07115	Gjoha, kamatëvonës, sekuestrime e zhdëmtime	173,561	297,991
7116	Të ardhura nga transferimi i pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje	0	0
<b>719</b>	<b>3. Të tjera të ardhura jo tatimore</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

### 3. Grante korente:

- **Llogaria 72 “Grante korente”**, në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 350,700,411 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 380,206,702 lekë ose me një rritje në vlerën 29,506,291 lekë. Analiza e detajuar e llogarisë grante korente paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
72	<b>V. GRANTE KORENTE</b>	<b>380,206,702</b>	<b>350,700,411</b>
720	<b>1. Grant korent i brendshëm</b>	<b>380,206,702</b>	<b>350,700,411</b>
7200	Nga Buxheti për NJQP (Qendrore)	364,911,685	330,284,182
7201	Nga Buxheti për NJQP (Vendore)	0	0
7202	Nga Buxheti për pagesa të posaçme te ISSH	0	0
7203	Nga Buxheti për mbulim deficitit (ISSH e ISKSH)	0	0
7204	Pjesëmarrje e institucioneve në tatime nacionale	14,999,217	9,001,881
07205	Financim shtesë për të ardhurat e krijuara brenda sistemit	0	0
7206	Financim i pritshëm nga buxheti	0	11,214,348
7207	Sponsorizime të brendshme (nga të tretët)	295,800	200,000
7209	Të tjera grante korente të brendshme	0	0
721	<b>2. Grant korent i huaj</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
	Nga Qeveri të Huaja	0	0
	Nga Organizata Ndërkombëtare	0	0

## SHPENZIMET

### 1. Shpenzimet për pagat, përfitimet e punonjësve dhe kontributet shoqërore:

- **Llogaria 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve”** në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 106,864,145 lekë, ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 127,668,717 lekë ose me një rritje në vlerën 20,804,572 lekë.

- **Llogaria 601 “Kontributi i sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”**, në datën 31.12.2023, ka qenë në vlerën 15,045,689 lekë, ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë 18,708,325 lekë ose me një rritje në vlerën 3,662,636 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Tepelenë me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar për llogaritë e pagave dhe kontributeve për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
6001	Paga, personel i përhershëm	127,668,717	106,864,145
6002	Paga personel i përkohshëm	0	0
6003	Shpërblime	0	0
6009	Shpenzime të tjera të personelit	0	0
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	18,708,325	15,045,689
6011	Kontribut i Sigurimeve Shëndetësore	0	0
	<b>Totali</b>	<b>146,377,042</b>	<b>121,909,834</b>

### 2. Blerje mallra dhe shërbime:

Llogari e cila përfshin të gjitha shpenzimet për blerjen e materialeve dhe kryerjen e shërbimeve të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së institucionit.

- **Llogaria 602 “Blerje mallra dhe shërbime”**, në datë 31.12.2023, ka qenë në vlerën 44,867,526 lekë ndërsa në datën 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie ka qenë në vlerën 36,848,029 lekë ose me një pakësim në vlerën 8,019,497 lekë. Këto shpenzime janë të rakorduara me Degën e Thesarit Tepelenë me të njëjtën vlerë. Analiza e detajuar e llogarisë blerje mallra dhe shërbime paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Lekë

Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
602	<b>III. BLERJE MALLRA E SHËRBIME</b>	<b>36,848,029</b>	<b>44,867,526</b>
602	Mallra dhe shërbime të tjera		
6020	Materiale zyre e të përgjithshme	1,966,206	1,124,500
6021	Materiale dhe shërbime speciale	1,488,488	1,118,744
6022	Shërbime nga të tretët	14,866,963	12,920,842
6023	Shpenzime transporti	4,723,870	4,110,179
6024	Shpenzime udhëtimi	456,900	739,000
6025	Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme	4,793,004	762,600
6026	Shpenzime për qiramarrje	0	0
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	119,828	4,000,000
6028	Shpenzime të lidhura me huamarrjen për hua	0	0
6029	Shpenzime të tjera operative	8,432,750	20,091,661

### 3. Subvencionet:

Përfshin ato shpenzime korrente të cilat konsiderohen si një mbështetje e qeverisë për subjekte prodhuese apo të shërbimeve, pavarësisht nga pronësia dhe përfituesi. Bashkia Memaliaj nuk ka pasur subvencione për periudhën nga data 01.01.2024, deri më 31.12.2024.

### 4. Transferime korente:

Gjendja e llogarisë së fondeve **604 “Transferime të brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 8,802,894 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Gjendja e llogarisë së fondeve **606 “Transferime për Buxhetet familjare e Individë”** paraqitet në bilanc për vitin 2024 në vlerën 139,892,850 lekë e cila rakordon me akt rakordimin me Thesarin.

Lekë			
Llogaria	Emërtimi	31.12.2024	31.12.2023
	<b>V. TRANSFERIME KORENTE</b>	<b>148,695,744</b>	<b>150,186,714</b>
<b>604</b>	<b>1. Transferime korente të brendshme</b>	<b>8,802,894</b>	<b>6,740,303</b>
6040	Transferime korente tek nivele të tjera të Qeverisë	8,802,894	6,740,303
6041	Transferime korente tek institucione qeveritare të ndryshme	0	0
6042	Transferime korente tek sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	0	0
6044	Transferime korente tek organizata jo fitimprurëse	0	0
<b>606</b>	<b>3. Transferime për buxhetet familjare e individë</b>	<b>139,892,850</b>	<b>143,446,411</b>
6060	Transferta të paguara nga ISSH e ISKSH	0	0
6061	Transferta të paguara nga institucione të tjera të organeve të pushtetit vendorë	139,892,850	143,446,411

**Për vitin 2024** totali i të ardhurave në vlerë është 399,671,919 lekë dhe totali shpenzimeve është 331,161,913 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 68,510,006 lekë e cila kuadron me gjendjen e llogarisë 85 “Rezultat i veprimtarisë së vitit ushtrimor” në vlerën 68,510,006 lekë.

#### ➤ **Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës:**

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore konstatohet se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

#### ➤ **Veprimet nëpërmjet magazinës:**

- Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si fletë-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje konstatohet se veprimet ishin kontabilizuar saktë.

- Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara nga titullari i institucionit.

- Janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre ekziston viti i krijimit si dhe janë evidentuar shtesat dhe pakësimet për to, por nuk është mbajtur një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve të trupëzuara sipas modelit klasik të trajtuar më lart, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 30.

- Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

➤ **Auditim mbi zbatimin e dispozitave ligjore në kryerjen e pagesave për pagat e punonjësve, shtesat mbi to , shpërblimeve.**

Nga Bashkia Memaliaj është mbajtur dhe përditësuar libri dhe ditari i pagave. Ato hartoheshin sipas standardeve të kontabilitetit, ku plotësoheshin pagat me të gjithë elementet dhe shtesa të ndryshme të përfituara deri tek shuma bruto. Po kështu pasqyroheshin llojet e ndalesave deri tek paga neto. Përmbledhëset janë të kuadruar me listë pagesat dhe me urdhër pagesat respektive, të nënshkruara nga punonjësi i financës dhe titullari.

Për të gjithë periudhën e kontrolluar, janë përlllogaritur, ndaluar dhe xhiruar detyrimet për kontributin e sigurimeve shoqërore dhe tatimin mbi të ardhurat. Janë respektuar strukturat organike të miratuara përsa i përket numrit të punonjësve si dhe janë respektuar dispozitat ligjore për kohëzgjatjen e punës.

**Numri i punonjësve dhe fondi i pagave:**

Pasqyra nr. 8, jep informacion mbi numrin e punonjësve, ndryshimet gjatë vitit ushtrimor të mbyllur si dhe gjendjen në fund të periudhës, fondin e pagave gjithsej, kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si dhe informacion mbi tatimin mbi të ardhurat. Bashkëlidhur janë edhe llogaritë debitore dhe kreditorë në mënyrë analitike, si dhe evidencën përmbledhëse të përdorimit të fondeve.

Programimi i PBA 2024-2026 dhe programimi i buxhetit vjetor 2024:

Me Urdhrin nr. 08, datë 27.01.2022, është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2024- 2026.

Planifikimi i programit buxhetor afatmesëm 2024- 2026 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak, me nr.59 datë 28.09.2023, konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Gjirokaster: me shkresën nr. 839/1prot date 09.10.2023.

PBA (faza fillestare dhe përfundimtare) janë miratuar në Këshillin Bashkiak me vendimet:

Viti i parë i PBA është njëkohësisht edhe vit buxhetor vjetor.

Gjatë hartimit të PBA, 2024-2026 janë përcaktuar “Përshkrimi i çdo programi”; “Politikat e programit”; “Qëllimi Politikës së programit”; “Objektivat e politikës së programit”.

PBA	Urdhëratë GMS		Urdhëratë EMP		VKB			Nr.	shënime
	Nr.	Datë	Nr.	Datë	Objekti	Nr.	Datë	Programe	
2024-2026	08	27.01.2022	81	27.01.2022	miratim kalendari	81	20.12.2023	12	

					miratim tavaneve të shpenzimeve	59	28.09.2023	12	
2024	08	27.01.2022	08	27.01.2022	miratimi i tabelave të PBA	91	27.12.2023	12	

Burimi: Drejtoria e Financës

Miratimi i tavaneve të buxhetit afatmesëm 2024-2026 Vendim i Këshillit Bashkiak nr. 59 datë 29.09.2023., brenda afatit të kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 37.

Vendimi i Këshillit Bashkiak me nr. 91 datë 27.12.2023, “Për vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të të ardhurave të Bashkisë Memaliaj për vitet 2024-2026”, jo më vonë se 31 Janar, brenda afatit të kërkesave të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 34.

Për vitin 2024, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr. 93 datë 27/12/2023, konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Gjirokaster me shkresën nr. 1083/1.prot date 08.01.2024..

Në këtë VKB, të ardhurat nga burimet e veta të planifikuara për vitin 2024 kanë vlerën 78.472 mij lekë, transfertat e pakushtëzuar ka vlerën 138.087 mij lekë, transfertat specifike ka vlerën 102.615 mij lekë.

Në total të ardhurat kanë vlerën 319.174 mij lekë dhe shpenzimet kanë vlerën 328,779 mij lekë.

Gjatë vitit 2024, Bashkia Memaliaj ka ndryshuar vlerat e buxhetit bazë (miratuar në dhjetorë 2023).

Këto ndryshime paraqiten si vijon:

	Emërtimi	Buxheti Faktik 2023	Faza e I PBA 2024	Faza e II PBA 2024	Projekt Buxhet 2024
600	Paga	128,865	166,670	170,282	166,670
601	Sigurime Shoqërore	18,903	26,506	27,606	26,506
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	62,485	55,590	63,591	55,590
604.603	Mallra dhe Shërbime të Tjera	4,186	6,993	6,993	6,993
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	2,436	20,215	20,214	20,215
I	Shpenzime Korrente	216,875	275,974	288,686	275,974
230	Kapitale të Patrupëzuara	337	1,000	8,060	1,000
231	Kapitale të Trupëzuara	29,495	42,200	40,450	42,200
	Shp. Kapitale me financim te brendshem	29,932	43,200	48,510	43,200
230	Kapitale të Patrupëzuara				
	Shpenzime Kapitale me financim te huaj				
II	Shpenzime Kapitale				
III	Shpenzime nga Të ardhurat jashtelimiti				
I+II +III	Totali I Shpenzimeve	246,707	319,174	337,196	319,174

Gjatë vitit 2024, janë marrë gjithashtu edhe disa vendime të tjera të këshillit bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë (miratuar në dhjetor 2023). Këto ndryshime paraqiten si vijon:

Tabela e ndryshimeve buxhetore 000/lek

Periudha buxhetore	Buxheti Fillestar		Ndryshime gjate viteve		Ku kanë ndodhur ndryshimet e buxheteve					
	Nr/ datë	Vlera	Nr/ datë	Vlera	Pakësuar artik (me emër)/ shtuar artikull (me emër)					
					SHTESA art.	shuma	PAKSIME art.	shuma		
Viti 2024	Nr. 91 datë 27.12.2023	319,174	Nr.11788,dt. 04.09.2024		600+601,Paga dhe sigurime.		600+601,Paga dhe sigurime.	0		
					602- 609 ShP. te tjera	28,654	602, ShP. operative			
					230+231 (Investime)	XXX	230+231 (Investime)	0		
			Nr.XX,dt. Xx.xx.202x		0	0	600+601,Paga dhe sigurime.		600+601,Paga dhe sigurime.	0
							602- 609 ShP. te tjera		602, ShP. operative	
							230+231 (Investime)	XXX	230+231 (Investime)	
			Nr.XX,dt. Xx.xx.202x		0	0	600+601,Paga dhe sigurime.		600+601,Paga dhe sigurime.	0
							602, ShP. operative		602, ShP. operative	
							230+231, investime		230+231 (Investime)	
			Buxheti shtesë		28,654	0	600+601,Paga dhe sigurime.	0	600+601,Paga dhe sigurime.	0
							602, ShP. operative		602, ShP. operative	0
							606	XXX	606	0

Burimi: Drejtoria e Financës, Kontabilitetit dhe Menaxhimit të Pronave

**Pasqyrë përmbledhëse për planifikimin e buxhetit për vitin 2024 sipas VKB përkatëse.**

Të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2024 janë planifikuar të balancuara në vlerën 319,174 mijë lekë, sipas tabelës në vijim:

Tabela Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2024

*në mijë lekë*

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2024				Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2024			
Burimi i të ardhurave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB nr. 93 datë 27.12.2024	Buxheti shtesë VKB nr.XX date XX.OX.202X; VKB nr.XX date XX.XX.202X; VKB nr.XX date XX.XX.202X; si dhe akt norm.11788dt.04.09.2024; miratuar me urdher titullari dheakt normativ shperblimfundviti	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë)	Emërtimi i zërave	Buxheti fillestar, miratuar me VKB nr.93datë 28.12.2023	Buxheti shtesë VKB nr.XX date XX.OX.202X; VKB nr.XX date XX.XX.202X; VKB nr.XX date XX.XX.202X; si dhe akt norm.XXdX.XX.XX; miratuar me urdher titullari dheakt normativ shperblimfundviti	Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë)
	1	2	1+2		1	2	1+2
Të ardhura të planifikuara për vitin 2024	31,345	0	31,345	Art. 600 Paga	166,670	3611	170,281
Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm	18,300	0	18,300	Art.601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	26,506	1100	27,606

dhe te planifikuara për shpenzim për vitin 2024							
Total të ardhurat e veta	49,645	0	49,645	Art.602 Shpenzime operative	56,590	23,943	80,533
Të ardhura të trashëguara nga granti i pakushtëzuar	28,827	0	28,827	Art.604 Transferime korrente të brendshme	6,993		6993
Të ardhura të trashëguara nga transfertat specifike				Art. 606 Transferime te buxhetit familjar dhe individë	1000	0	1000
Transferta e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2024	138,087	28,654	166,741	Art. 230-231 Investime	43,200		43200
Transferta specifike e çelur për llogari të vitit 2024	102,615		102,615	Fondi Rezervë + gjencës (609)	18,215		18,215
Transferta e pakushtëzuar specifike							
Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit te shtetit	269,529	28,654					
Totali i të ardhurave	319,174	28,654	347,828	Totali i shpenzimeve	319,174	28654	347,828

Burimi: Drejtoria e Financës, Kontabilitetit dhe Menaxhimit të Pronave

## 2.3 Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Tabela mbi treguesit buxhetor dhe burimin e financimit të shpenzimeve: në 000 lekë

Buxheti përfundimtar Plan-Fakt Bashkia memaliaj, për vitin 2024.											
Nr	Përshkrimi Shpenzimeve	Plani	Fakti	Realizimi ne %	Burimi i financimit të shpenzimit						
					Nga të ardhurat e veta	% e mbulimit nga të ardhurat e veta	Nga Granti Qeveritar				% e mbulimit nga grantet
							Nga transfertat e pakushtëzuar	Nga transfertat e kushtëzuar specifike	Nga transfertat e kushtëzuar për funksionet e deleguara	Nga transfertat e kushtëzuar për investimet	
1	Paga 600	170,281	158,281	93	0	0					100
2	Sigurime shoqërore 601	27,606	23,994	87	0	0					100
3	ShP. Operat 602+ F. Rezervë	101,431	66,333	65.3	23,852	23.2					76.8
4	Nd/Ekonom invalid 606	134,795	134,226	99,5	0	0			134,226		100
5	Investime 230-231	326,864	246,173	75	27,985	8.6				298,879	91.4
	<b>Totali</b>	<b>760,976</b>	<b>629,007</b>	<b>82.6</b>							

Burimi: Drejtoria e Financës, Buxhetit dhe Kontabilitetit

Lista e investimeve të reja parashikuar në buxhetin vjetor të vitit 2024 nga të ardhurat e veta dhe granti

Nr	Emërtimi i investimit	Nr dhe data e VKB	Burimi financimit	Vlera e miratuar në VKB	Vlera e realizuar e investimit (me TVSh) vetem viti 2024	% e realizimit
1	Rikonstruksion salla e K.Bashkiak	Nr 93 dt27.12.2025	Teardhurat e veta	3,000	0	0
2	Blerje e automjetit (furgon)			2,000	1,860	99%
3	Blerje kompjutera,printer,kamera			2,000	898	38.95
4	Rikonstruksion rrugë:rrugët e brendshme Qytet Memaliaj,segmenti I levan-Allkomemaj,rrugët e brendshme fshati Kalivac,unaza fshati Izvor,Unaza fshati Vasjar,unaza ne fshatin RRapaj			33,000	23,782	72%
5	supervizime			700	739	
6	kolaudime			300	227	75
7	Blerje materiale per ngrohje per shkollat			500	0	0
8	Blerje peme			500	479	95.8
9	Thurje vend depozitimi I mbetjeve			1,200	0	0
	Total të ardhurat e veta+grand pa kushtezuar			43,100	27,985	65
1						
1	Total Grant Kushtezuar					
	Total nga te ardhura jashtelimitit					

### Planifikimi i detyrimeve të prapambetura në planin e vitit buxhetor 2024

*Në 000/lekë*

Kodi detyrimit të prapamb.	Emerimi i detyrimit të prapambetur	Deyrimi prapambetur progresiv deri në datën e miratimit të buxhetit vjetor 31.12.2023	Shtesa detyrimi i prapambetur gjatë vitit 2024 i vlerës së detyrimit të prapambetur	Pagesa në fakt gjatë vitit 2024 detyrimit të prapambetur të planifikuar në planin e buxhetit	Total Detyrimi i prapambetur 31.12.2024
4864100	Detyrime per vend.gjyqesore	182,235	0	31,828	150,407
4864200	D.P.persherbime	1,702,479	885,203	1,522,479	1,065,203
486201	D.P.energji elektrike	6,823,953	229,446	833,857	6,219,542
4864300	D.P.permirembajtje	576,382	1,749,988	576,382	1,749,988
4864400	D.P.per investime				
4864400	D.P.per investime nga Ministrite e Linjes (specifiko FZHR etj...)	40,449,735	0	40,449,735	0
4865600	D.P per mallra	1,249,958	2,329,575	1,249,958	2,329,575
4864900	D.P.te tjera				
	<b>Totali</b>	<b>50,984,742</b>	<b>5,194,212</b>	<b>44,664,239</b>	<b>11,514,715</b>

Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimeve gjyqësore, vendimeve të shpronësimit dhe niveli i realizimit të të ardhurave (faturat e pa likujduara të shoqërohen me listë analitike të detajuar me nr. fature, datë krijimi etj., sipas raportimit në MFE)

### Tabela e detyrimeve të prapambetura sipas formatit të raportuar në MFE për vitin 2024

Kodi i detyrimit të prapamb.	Emerimi i detyrimit të prapamb.	Detyrimi prapambetur progresiv më 31.12.2023	Vlera e paguar gjatë vitit 2024 për detyrimin e prapambetur (vlera e paguar për kolonën 3) (pakesime 2024)	Vlera e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më 31.12.2024 (pa detyrimet e krijuara gjatë 2024) (shtesat 2024)	Vlera totale e detyrimeve të prapambetur pa më 31.12.2024
1	2	3	4	5	6
4864100	Vendime Gjyqësore	182,235	31,828	150,407	150,407
4864200	Shërbime	1,702,479	1,522,479	180 000	1,065,203
4864201	Energji elektrike	6,823,953	833,857	5,990,096	6,219,542
4864300	Mirëmbajtje	576,382	576,382		1,749,988

4864400	Investime	40,449,735	40,449,735		
4864600	Mallra	1,249,958	1,249,958		2,329,575
4864900	Të Tjera				
4864902	Shpronësime				
	<b>Totali</b>	<b>50,984,742</b>	<b>44,664,239</b>	<b>6,320,503</b>	<b>11,514,715</b>
Detyrime te prapambetura nga FZHR (Ministrite e linjës)					0
<b>Detyrime ne total</b>					<b>11,514,715</b>

Evidencat mbi realizimin e të ardhurave (taksa e tarifa vendore) për periudhën objekt auditimi, konfirmuar nga Dega e Thesarit në Rreth, pasqyra:

**Në 000/lekë**

Nr	Lloji i Taksës	Viti 2021		
		Plan	Fakt	%
a	b	7	8	9
I	Te ardhura nga Tatimet	2,000	92	4.6
1	Tatimi Thjesht mbi Fitimin	2,000	92	4.6
II	Te ardhura nga Taksat	13,800	11,925	87
2	Taksa mbi B. Vogel	0	0	0
3	Taksa e Pasurisë, ndërtese	3,400	2,644	77.7
4	Taksa mbi token Bujqesore	4,700	4,530	96
5	Takse mbi rregj e Automjete	3,000	3,773	125.7
6	Taksa e ndik te nd mbiinfrast	2,000	559	28
7	Takse Tabele	200	124	62
8	Takse hoteli	0	21	
9	Takse Parkimi			
10	Takse Tregu	300	206	69
11	Takse per hapësira publike			
12	Takse Trualli	0	68	
13	Takse reklame			
14	Takse studimi urbanistik	2,000	0	0
III	Te ardhura nga Tarifat	15,545	16,609	106.8
15	Tarife Pastrimi	4,700	3,847	82
16	Tarife gjelberimi	465	280	60
17	Tarife ndricimi	130	1028	79
18	Tarif leje transporti	300	310	103
19	Tarif parkimi	200	200	100
20	Tarife qera toke bujqesore	1,000	272	27
21	Tarife pe objekte me qera	250	190	76
22	Tarife qera trualli per antenat	1,900	3,073	162
23	Tarife zenie hapsir publike	100	0	0
24	Te tjera tarifa (nga shitja e mallrave)	200	51	25
25	Te tjera te ardhura	800	395	49
26	Tarife dru zjarri	500	284	57
27	Te ardhura nga shëbimet eMSHZ	0	35	
28	Tarifa per kullota	700	0	0
29	Tarifa per shtypshkrimet	500	94	19
30	Tarife sherbime funerali	0	385	
31	Sponsorizime	0	296	
32	Kamat vovesa	0	174	
33	Tarif ushqimi nga kopshtet	800	589	74
34	Tatime te ardhurave ne burim	3,000	5,092	169.7
35	Tarif vendore per leje zhvillimi	0	4	
	<b>GJITHSEJ ( I+II+III+ IV)</b>	<b>31,345</b>	<b>28,626</b>	<b>91.3</b>

Niveli i detyrimeve të papaguara në fund të periudhave 2024, paraqitet si vijon, pasqyra:

Emërtimi	Viti 2023		Viti 2024		Viti 2024 Kontabilizuar	
	Nr.	Vlerë/Lekë	Nr.	Vlerë/Lekë	Nr.	Vlerë/Lekë
Nga subjektet fizik						
Nga subjektet juridik						
Nga ambientet familjarë						
Nga taksa e tokës bujqësore						
Nga taksa infrast (ALUIZNI)						
Nga taksa infrast (DPZHT)						
Nga kontratat						
Gjoha te ndryshme						
Nga kamat vonesa nëse ka						
Të tjera						
<b>TOTALI</b>		39,991,494		8,445,631		48,437,125

Buxheti fillestar për vitin 2024 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 93, datë 27.12.2023, dhe është konfirmuar nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

Totali i të ardhurave të planifikuara: 319,174 mijë lekë

Totali i shpenzimeve të planifikuara: 328,779 mijë lekë

Pavarësisht se buxheti u miratua me balancë pozitive formale, gjatë vitit 2024 janë kryer disa akte shtesë dhe ndryshime buxhetore që kanë ndikuar në strukturën dhe vlerat e tij, përfshirë alokime të fondeve të trashëguara nga viti 2023, shtesa për paga dhe sigurime si pasojë e ndryshimeve në nivelin minimal të pagave dhe alokime për investime, mirëmbajtje dhe pagesa të detyrimeve të prapambetura

#### *Krahasimi Plan-Fakt për Shpenzimet dhe Të Ardhurat*

Bazuar në raportet e monitorimit dhe evidencat nga drejtoria e financës:

Plani i shpenzimeve totale për vitin 2024: 760,976 mijë lekë

Shpenzimet faktike të realizuara: 629,007 mijë lekë

**Përqindja e realizimit: 82.6%**

Ky nivel realizimi konsiderohet mesatarisht i kënaqshëm, megjithatë disa zëra janë realizuar tej mase, ndërsa të tjerë kanë mbetur shumë poshtë pritshmërive.

#### *Shqyrtimi i Detyrimeve të Prapambetura*

Në përfundim të vitit 2024, Bashkia Memaliaj rezulton me një nivel të lartë të detyrimeve të prapambetura ku totali i detyrimeve në fund të vitit: 11,514,715 lekë

Ndër problemet më të theksuara janë:

- Energji elektrike ndaj OSHE: mbi 6.2 milionë lekë, përfshirë edhe kamatëvonesa.
- Detyrime për shërbime e mirëmbajtje, ku përmenden shuma të larta ndaj subjekteve si SHZA K. shpk dhe Ujësjiellësi Rajonal.
- Vendime gjyqësore të papaguara, përfshirë vendimet ndaj subjekteve private si G. shpk dhe B. shpk.

Ky nivel i detyrimeve tregon për dobësi në menaxhimin financiar, mospërputhje mes angazhimeve dhe fondeve të disponueshme, dhe ekspozon institucionin ndaj riskut ligjor dhe financiar.

#### *Analizë e Investimeve*

Në buxhetin vjetor 2024 janë parashikuar 326,864 mijë lekë për investime, përmes kodeve ekonomike 230 dhe 231.

Shpenzimet faktike të realizuara për investime: 246,173 mijë lekë

### **Realizimi: 75% e planit**

Disa nga projektet e planifikuara që nuk janë realizuar plotësisht përfshijnë:

- Rikonstruksione rrugësh dhe objekte publike
- Pajisje për administratën (kompjuterë, automjete)
- Projekte me financim nga grantet, të cilat nuk janë çelur plotësisht

Kjo tregon për vonesë në procedurat e prokurimit, pengesa në zbatimin teknik, ose mungesë të burimeve të sigurta financiare.

### *Verifikimi i Realizimit të të Ardhurave Vendore*

Bashkia Memaliaj kishte planifikuar të ardhura vendore në masën:

Plani: 31,345 mijë lekë

Fakti: 28,626 mijë lekë

### **Realizimi: 91.3%**

Përqindja e realizimit është përgjithësisht pozitive, por janë evidentuar probleme me:

- Taksën e ndikimit në infrastrukturë (realizuar vetëm 28%)
- Taksën mbi ndërtesën (realizim 77.7%)
- Taksën e tabelës dhe truallit (realizim shumë i ulët)
- Tarifa për qera tokë bujqësore dhe zenie hapësirash publike (realizim nën 30%)

Këto të dhëna tregojnë për mangësi në mbledhjen dhe administrimin e të ardhurave, si dhe mungesë ndjekjeje për debitorët.

**Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. A.M. Kryetar i Bashkisë Memaliaj në cilësinë e Nëpunësit Autorizues dhe z. B.C. Drejtor i Drejtorisë së Financës në cilësinë e Nëpunësit Zbatues dhe hartuesit të pasqyrave financiare.**

## **2.3. Verifikimi i ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.**

### **I. Respektimi i afatit prej 20 ditësh, për informimin e KLSH-së mbi planin e veprimeve të subjektit për zbatimin e rekomandimeve të lëna:**

Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion konstatohet se, nga Bashkia Memaliaj nuk janë marrë masat e duhura për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve duke mos respektuar kështu edhe afatin 20 ditor. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15, gërma “j”, ku përcaktohet që:

<i>j) të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës.</i>
---

### **II. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh, për raportimin në KLSH, të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve të lëna:**

Bashkia Memaliaj me shkresën nr. 1500/1 prot., datë 24.07.2024, ka raportuar pranë KLSH-së ecurinë së zbatimit të rekomandimeve duke respektuar kështu edhe afatin 6 mujor, në përputhje me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2.

### **III. Rekomandimet e KLSH-së:**

Sipas shkresës përcjellëse të Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Bashkinë Memaliaj administruar në KLSH me nr. 494/8 prot., datë 03.07.2024, dhe protokolluar në Bashkinë Memaliaj me nr. 1500 prot., datë 05.07.2024, janë rekomanduar gjithsej:

- 16** masa organizative;
- 1** masë për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore përfshirë edhe detyrimet nga qiradhënie në vlerën **20,273,000 lekë**;
- 1** masë për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, me efekt mungesë të ardhurash në vlerën **2,525,000 lekë**;
- 1** masa disiplinore;

### **IV. Statusi i pranimit të rekomandimeve të KLSH-së:**

Masat	Rekomanduar	Pranuar	Pa pranuar
Masa organizative	16	16	0
Masa për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia	1 20,273,000	1	0
Masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, me efekt mungesë të ardhurash	1 2,525,000	1	0
Masa disiplinore	1	1	0
<b>Totali</b>	<b>19</b>	<b>19</b>	<b>0</b>

### **V. Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e Bashkisë Memaliaj:**

Rekomandime	Rekomanduar	Të zbatuara	Të zbatuara pjesërisht	Në proces zbatimi	Të pa zbatuara
Masa organizative	16	2	4	3	7
Masa për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia	1 20,273,000	0	0	1	0
Masa për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, me efekt mungesë të ardhurash	1 2,525,000	0	0	0	1
Masa disiplinore	1	0	0	0	1
<b>Totali</b>	<b>19</b>	<b>2</b>	<b>4</b>	<b>4</b>	<b>9</b>
<b>Totali në %</b>	<b>100%</b>	<b>10.5%</b>	<b>21.05%</b>	<b>21.05%</b>	<b>47.4%</b>

**Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:**

#### **A. MASA ORGANIZATIVE**

**1.1. Rekomandimi:** Strukturat përgjegjëse, të marrin masa për plotësimin e mangësive të evidentuara si dhe implementimin e një sistemi të përshtatshëm rregullash të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konform përcaktimeve të ligjit të MFK-së dhe aktet në zbatim të tij, për ta bërë atë efektiv dhe në dobi të veprimtarisë institucionale.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

<p><b>Statusi i rekomandimit: I pranuar.</b></p> <p><b>Koment i grupit të auditimit:</b> Me shkresën nr. 1207 prot., datë 23.05.2024, të Kryetarit të Bashkisë z. A.M. dhe Urdhrin nr. 78, datë 23.05.2024, është caktuar znj. K.Sh. si punonjës për menaxhimin e riskut. Me shkresën nr. 1026 prot., datë 30.04.2024, dhe shkresën nr. 155 prot., datë 03.10.2024, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik i përbërë nga 8 (punonjës). Me Urdhrin nr. 7, datë 12.01.2024, të Kryetarit të Bashkisë është miratuar struktura organizative të bashkisë për vitin 2024, së bashku edhe me organigramën. Ndërsa rregulloret e brendshme të institucionit është miratuar me VKB-në nr. 12, datë 28.02.2023. Ndërkohë që nuk është hartuar strategjia e riskut pra nuk është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, vlerësimi, për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave.</p> <p><b>Rekomandimi është zbatuar pjesërisht</b></p>
---

**2.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Memaliaj dhe sektori i Burimeve Njerëzore të marrin masa që Njësia e Auditimit të Brendshëm të organizohet dhe të funksionojë, sipas strukturës së miratuar me 3 punonjës.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Statusi i rekomandimit: I pranuar.**

**Koment i grupit të auditimit:** Me Urdhrin nr. 7, datë 12.01.2024, të Kryetarit të Bashkisë është miratuar struktura organizative të bashkisë për vitin 2024, në të cilën është përfshirë edhe Njësia e Auditimit të Brendshëm e përbërë nga tre pozicione pune konkretisht, 1 përgjegjës sektori dhe 2 specialist.

**Rekomandimi është zbatuar**

**3.1. Rekomandimi:** Bashkia Memaliaj, Drejtoria e Financës, të marrin masa që gjatë vitit buxhetor të hartohen tre raporte katër mujor për monitorimin e zbatimit të buxhetit, të cilat të dërgohen gjithashtu në MFE. Kryetari i Bashkisë të miratojë rregulla specifike dhe procedurale që duhet të ndiqen në procesin e monitorimit të zbatimit të buxhetit.

*Në vijimësi*

**Statusi i rekomandimit: I pranuar.**

**Koment i grupit të auditimit:** Me shkresën nr. 1893/1 prot., datë 22.10.2024, është dërguar pranë Këshillit Bashkiak Memaliaj, Raporti mbi monitorimin e buxhetit të bashkisë për 8 mujorin 2024. Me shkresën 928/1 prot., datë 18.04.2025, Bashkia Memaliaj ka dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Raportin mbi monitorimin e buxhetit të institucionit për vitin 2024. Me shkresën nr. 1196/1 prot., datë 27.05.2025, Bashkia Memaliaj ka dërguar pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Raporti i treguesve të realizimit të buxhetit të institucionit për 4 mujorit të parë të vitit 2025.

**Rekomandimi është zbatuar pjesërisht**

**4.1. Rekomandimi:** Bashkia Memaliaj, Drejtoria e Financës, të marrë masa për likuidimin e detyrimeve të prapambetura duke hartuar plane të detajuara për këtë qëllim dhe të raportojë periodikisht në MFE vlerat e detyrimeve të prapambetura faktike.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Statusi i rekomandimit: I pranuar.**

**Koment i grupit të auditimit:** Referuar aktrakordimit të mbajtur me Degën e Thesarit Tepelenë, lidhur me gjendjen e detyrimeve që Bashkia Memaliaj ka ndaj të tretëve konstatohet se, më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 11,514,715 lekë. Në total për vitin 2024 shuma e detyrimeve të prapambetura paraqitet në vlerën 56,179,224 lekë nga të cilat është likuiduar vlera 44,664,509 lekë, ndërsa gjendja më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 11,514,715 lekë. Pra këto detyrime kanë mbetur në masën 20.4% nga vlera fillestare.

**Rekomandimi është zbatuar pjesërisht**

**5.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Memaliaj të marrë masa për ngritjen e një grupi pune për identifikimin e gjendjes dhe numrit të aseteve të cilat i janë transferuar në pronësi në mënyrë përfundimtare, si dhe të fillohet përgatitja e dokumentacionit tekniko ligjor të secilit prej tyre për të vijuar me aplikimet përkatëse për pajisje me çertifikatë pronësie.

*Menjëherë*

**Statusi i rekomandimit: I pranuar.**

**Koment i grupit të auditimit:** Në lidhje me ndjekjen e ecurisë për pajisjen me çertifikatë pronësie të pasurive që disponon Bashkia Memaliaj janë ndjekur hapat e mëposhtëme:

- Është kryer aplikimi në ASHK për çertifikatën e pronësisë, me shkresën nr. 2605 prot., datë 20.11.2024, për objektin Shkollën e Mesme "Sali Nivica" me numër pasurie 9/2 ZK 2646;

- Është kryer aplikimi në ASHK për çertifikatën e pronësisë, me shkresën nr. 908 prot., datë 16.04.2025, për objektin Ish-Spitali i Minierës me numër pasurie 5/388 ZK 2646;

- Është kryer aplikimi për statusin juridik në ASHK me nr. 56; 56/1-20, për 20 pasuri në periudhën Prill-

Maj të vitit 2025.

**Rekomandimi është në proces zbatimi**

**6.1. Rekomandimi:** Drejtori i Financës në Bashkinë Memaliaj në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2024 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar.

*Deri më datë 31.03.2025*

**Statusi i rekomandimit: I pranuar.**

**Koment i grupit të auditimit:** Nga auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2024 konstatohet se, gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 0 lekë. Pra nuk janë kryer veprimet rregulluese sipas trajtimit kontabël duke kontabilizuar në këtë llogari detyrimet që i kanë institucionit duke e nënvlerësuar këtë llogari.

**Rekomandimi nuk është zbatuar**

**7.1. Rekomandimi:** Drejtorja e Financës në Bashkinë Memaliaj në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2024 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar, që për vlerat e detyrimeve afatshkurtra në lidhje me pagat, tatimin mbi të ardhurat, kontributet shoqërore e shëndetësore të muajit dhjetor të vitit ushtrimor, të paraqitura gabimisht në llogaritë e arkëtueshme analoge në aktiv të bilancit, ti kontabilizojë në mënyrë të saktë në gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” dhe në rakordim me gjendjen në llog.7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”, në Formatin e Performancës së PF.

*Deri më datë 31.03.2025*

**Statusi i rekomandimit: I pranuar.**

**Koment i grupit të auditimit:** Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2024 konstatohet se, në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, përmbledhsja e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 48,437,125 lekë, 42 “Detyrime ndaj personelit” në vlerën 11,181,933 lekë, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 900,979 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 1,971,655 lekë, 464 “Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë” në vlerën 357,603 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 11,514,715 lekë ku totali shkon në vlerën 74,364,010 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në vlerën 944,650 lekë.

**Rekomandimi nuk është zbatuar**

**8.1. Rekomandimi:** Drejtorja e Financës në Bashkinë Memaliaj të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës të studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 “Studime dhe Kërkime “dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura korresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë. Gjithashtu të bëjë korrektimet e duhura për llogaritjen e amortizimit të tyre dhe të bëjë sistemimet e kontabël përkatëse.

*Deri me datë 31.03.2025*

**Statusi i rekomandimit: I pranuar.**

**Koment i grupit të auditimit:** Nga auditimi i pasqyrave financiare konstatohet se, vlera e mbetur në fund të vitit 2024, prej 3,911,473 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”, për 20 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Gjithashtu për këtë llogari nuk është aplikuar amortizimi në masën 15% sipas metodës lineare.

**Rekomandimi nuk është zbatuar**

**9.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Memaliaj të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” dhe në llog. 211 “Pyje, Plantacione” dhe nëpërmjet Sektorit të Financës të kryejë zberthimin e dokumentacionit të financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

*Deri më datë 31.03.2025*

**Statusi i rekomandimit: I pranuar.**

**Koment i grupit të auditimit:** Nga auditimi i të dhënave analitike të aktiveve të institucionit për vitin 2024 konstatohet se llogaria 210 “Toka, troje, terrene” e pasqyruar në bilanc për vlerën 119,998 lekë dhe 211 “Pyje, kullota, plantacione” në vlerën 277,000 lekë janë të paanalizuara, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave për këto llogari.

**Rekomandimi është nuk zbatuar**

**10.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në Bashkinë Memaliaj të jetë e kujdesshme në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktive shafatgjata materiale dhe jo materiale, pasi për pagesa të vlerave pjesore të AQT duhet ti evidentojë ato në llogaritë 230-231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” deri në vlerë të plotë, dhe pas realizimit të punimeve dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave ti kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21, sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Statusi i rekomandimit: I pranuar.**

**Koment i grupit të auditimit:** Nga auditimi i pasqyrave financiare konstatohet se gjendja e llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 0 lekë, ndërkohë nga testimi i kontratave të investimeve punëve publike, evidentohet kontrata në proces të cilat duhet të kontabilizohen në gjendjen e kësaj llogarie konkretisht:

- Rikonstruksioni i shkarjeve të rrugëve të Njësive Administrative Buz-Lutfinjë në vlerën 20,675,896 lekë;

- Skema ujitëse vaditëse “Kanali ujitës” Krahas në vlerën 7,224,000 lekë;

- Rikonstruksioni i Gjimnazit dhe ambienteve sportive “Sali Nivica” në vlerën 53,557,000 lekë;

- Ujësjiellësi Rajonal në vlerën 179,028,083 lekë;

- Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara, Bashkia Memaliaj” në vlerën 30,934,440 lekë.

**Rekomandimi nuk është zbatuar**

**11.1. Rekomandimi:** Sektori i Taksave Vendore në Bashkinë Memaliaj, të forcojë në nivelet më të larta marrjen e masave për mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore, duke synuar realizimin e të ardhurave të veta si burim financimi për shpenzimet e planifikuara prej saj.

*Në vijimësi*

**Statusi i rekomandimit: I pranuar.**

**Koment i grupit të auditimit:** Referuar aktrakordimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore të datë 31.12.2024, me Degën e Thesarit Tepelenë, planifikimi vjetor për vitin 2024 është në vlerën 31,345,000 lekë ndërsa realizimi në vlerën 28,625,986 lekë në masën 91.3% me një diferencë mos realizimi në vlerën 2,719,014 lekë.

**Rekomandimi është në proces zbatimi**

**12.1. Rekomandimi:** Sektori Taksave Vendore, Administratorët e NJA-ve dhe Sektori i Bujqësisë, të nisë një kërkesë zyrtare ndaj Këshillit të Qarkut Gjirokastrë dhe në bashkëpunim të marrin masa për evidentimin e të gjithë familjeve me tokë bujqësore dhe të patakshuar, me qëllim planifikimin e saktë dhe arkëtimin e taksës së tokës bujqësore.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Statusi i rekomandimit: I pranuar.**

**Koment i grupit të auditimit:** Në vijim të zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH, Sektori i Tatim Taksave është drejtuar me kërkesën nr. 41 prot., datë 08.01.2025, Këshillit të Qarkut Gjirokastrë Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës Bujqësore, në lidhje me evidentimin e të gjithë familjeve me tokë bujqësore. Këshilli i Qarkut Gjirokastrë ka adresuar kthim përgjigje me shkresën nr. 35/1 prot., datë 21.02.2025, ku i citon se, Bashkia Memaliaj duhet t'i adresohet ZAMT-Tepelenë në lidhje me këtë informacion. Në vijim të korrespondencës të sipërcituar Bashkia Memaliaj është drejtuar me shkresën nr. 535 prot., datë 27.02.2025, ZAMT Tepelenë por edhe nuk ka një përgjigje zyrtare nga kjo e fundit.

**Rekomandimi është në proces zbatimi**

**13.1. Rekomandimi:** Bashkia Memaliaj të marrë masa për evidentimin e abonentëve familjarë, ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksën e ndërtesës, veçanërisht për ata të njesisë Memaliaj-Qytet, duke përditësuar regjistrin me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e shumës progresive 6,680,975 lekë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Statusi i rekomandimit: I pranuar.**

**Koment i grupit të auditimit:** Me shkresën nr. 177 prot., datë 24.01.2025, protokolluar në Shoqërinë Ujësjetllës Kanalizime Gjirokastrë dhe nr. 170 prot., datë 20.01.2025, në Bashkinë Memaliaj është hartuar marrëveshja për kryerjen e shërbimit të arkëtimin të detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në të cilën është vendosur edhe taksa e ndërtesës e cila do të mblihet nga ky Agjent Tatimor.

**Rekomandimi është zbatuar pjesërisht**

**14.1. Rekomandimi:** Sektori i Taksave Vendore bashkia Memaliaj në bashkëpunim me Sektorin Ligjor, të marrë masat e nevojshme për njoftimin e subjekteve për arkëtimin e vlerës prej **980,000 lekë**, dhe në rast të mos reagimit prej tyre të nisë procedurat për ndërprerjen e kontratës deri në likuidimin e detyrimeve.

*Menjëherë*

**Statusi i rekomandimit: I pranuar.**

**Koment i grupit të auditimit:** Referuar aktrakordimit të datës 31.12.2024, të mbajtur nga Dega e Thesarit Tepelenë për zërin tarifë qira trualli për antenat është arkëtuar vlera prej 2,114,677 lekë, nga OE "V." Sh.a në të cilën është përfshirë likuidimi i detyrimeve për vitet 2023-2024.

**Rekomandimi është zbatuar**

**15.1. Rekomandimi:** Sektori i Taksave Vendore në bashkëpunim me sektorin Juridik dhe Policinë Bashkiake, të marrin masat e nevojshme, për njoftimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në tregtimin e karburanteve të pa licensuar, për dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm për pajisjen me licensë dhe arkëtimin e detyrimit përkatës për licensimin, duke vijuar edhe me bllokimin e aktivitetit në rast të mos përgjigjes brenda një afati të vendosur në njoftim.

*Menjëherë*

**Statusi i rekomandimit: I pranuar.**

**Koment i grupit të auditimit:** Referuar përgjigjeve të paraqitura nga Bashkia Memaliaj në zbatim të pyetësorit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

**Rekomandimi nuk është zbatuar**

**16.1.Rekomandimi:** Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojmë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

Nisur nga fakti se disa nga rekomandimet e pazbatuar nga auditimet e mëparshme, si ato që kanë lidhje me MFK, pasqyrat financiare, buxhetin apo të ardhurat, janë rekomandime që dalin dhe në këtë auditim për një periudhë tjetër, bëhen të pazbatueshme, pasi nga auditimi i vitit 2023, janë të njëjtat mangësi që evidentohen në këto pika dhe rekomandohen masa të tjera të cilat dublojnë ato të kërkuara më parë, nuk janë rikërkuar nga grupi i KLSH,

## **B. Masa organizative**

**18.1 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Memaliaj, të marrë masa për krijimin dhe funksionimin e strukturës së kontrollit dhe mbrojtjes së territorit në nivel Inspektorati (Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit) jo vetëm si detyrim ligjor, por njëkohësisht për të bërë të mundur kontrollin e territorit në raport me ndërtime pa leje, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së zbatimit të lejeve të miratuara.

-Rekrutimin në stafin e IMTV të punonjësve me formimin profesional të fushës, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit.

### **B.1. Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm**

#### **a- Masa organizative:**

**14.1. Rekomandim:** Sektori i Tatimeve, Bashkia Memaliaj në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa për evidentimin e të gjithë subjekteve që zhvillojnë aktivitet, si dhe regjistrimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa leje, të peregjistruar në QKB, dhe të ndjekë procedurat ligjore për detyrimin e tyre për licencim. Bashkia Memaliaj të bashkëpunojë me QKB dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore Gjirokastrë, për përcaktimin e statusit të këtyre bizneseve dhe për ato biznese që kanë aktivitet të hapur të merret informacion zyrtar, mbi xhiron e subjekteve për të evidentuar nivelin e të ardhurave nga subjektet fizik/ juridik dhe mbi bazën e të ardhurave të realizuara në fund të periudhave ushtrimore të bëhet aplikimi i taksave e tarifave vendore në zbatim të Vendimeve të KB.

#### **b- Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara):**

**2.1. Rekomandim:** Sektori i Financës dhe Tatim-Taksave në bashkëpunim me NJA të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për evidentimin e abonentëve familjarë, ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore, dhe të hartohet regjistri përkatës me të dhënat e evidentuara në terren, si dhe të ndiqen të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës 5,239,500 lekë. Gjithashtu Bashkia Memaliaj të bashkëpunojë me UK sha Memaliaj duke lidhur Akt-marrëveshje për agjent tatimor për mbledhjen e taksës së ndërtesës dhe pastrim-gjelbërim-ndriçimit nga tatimpaguesit familjarë dhe nëse ka shmangie në lidhje me ndjekjen dhe mos arkëtim të detyrimeve të aplikohet masë administrative ndaj agjentit tatimor.

**3.1. Rekomandim:** Strukturat Drejtuese, të ngrëjë një grup punë me specialistë të fushës, për hartimin e regjistrimit të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, sipas të dhënave të marrë nga institucionet përgjegjëse (NJA/sectorët e bujqësisë, ZVRPP dhe Qarku Gjirokastrë), të nxjerrin njoftim detyrimet për familjet fermerë të lëna jashtë skemës së pagesës së taksës së tokës bujqësore. Për debitorët, të nxirren njoftim-vlerësimet për detyrimet për gjithë kohën e papaguar për familjet fermerë dhe për mos pagesat të ndiqen procedurat e tjera administrative e ligjore në strukturat e tjera kompetente, sipas rastit.

**6.1. Rekomandim:** Strukturat Drejtuese të Bashkisë Memaliaj nëpërmjet Sektorit të Bujqësisë, Sektorit Juridik dhe Integritet në BE, Sektorit Urbanistik dhe Menaxhimit të Aseteve, Sektorit të Financës dhe Tatim-Taksave të marrin masa dhe të ndjekin të gjitha kontraktore nga procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve qiradhënës në vlerën 4,364,486 lekë dhe

në rastet e mos pagesave të parashtrijë në KB, ku të marrë miratimin e tij për zgjidhjen e kontratave, që nuk janë efektive dhe kthimin e parcelave Bashkisë Memaliaj me inventar.

**19.2 Rekomandim:** Nga Bashkia Memaliaj të merren masat e duhura për raportimin në KLSH të ecurisë së zbatimit të rekomandimeve duke respektuar njëkohësit edhe afatin e raportimit.

**C. Masa për uljen e borxhit tatimor për të rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia (të ardhura të munguara)**

**1.1 Rekomandimi:** Sektori i Taksave Vendore Bashkia Memaliaj, të marrë masa për identifikimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitete në territorin administrativ të bashkisë, me qëllim përditësimin e regjistrit të taksave dhe tarifave për bizneset, si dhe në vijim nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët.

Sektori i Taksave Vendore Bashkia Memaliaj, të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, në vlerë **8,182,649 lekë**.

**2.1 Rekomandim:** Sektori i Taksave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Bujqësisë të marrë masa, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë 5,064,995 lekë, nga qiratë e tokës Bujqësore.

**2.2 Rekomandim:** Drejtoria Juridike të marrë masa, për ndryshimin e përmbajtjes së kontratave të qirasë për tokat bujqësore, duke reflektuar ndryshimin në kamatëvonesa dhe indeksimin e çmimit të qirasë çdo 5 vite.

**5.1 Rekomandim:** Sektori i Taksave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Zhvillimit Urban dhe Kadastrës Bashkia Memaliaj, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë në vlerën 536,448 lekë, sipas listës që disponon Sektori i Taksave Vendore Bashkia Memaliaj.

**6.2 Rekomandim:** Sektori e Taksave Vendore në bashkëpunim me Sektorin Ligjor Bashkia Memaliaj, të marrë masat e nevojshme për përditësimin e regjistrit me subjektet e mësipërme, si dhe ndjekjen e të gjitha procedurave të nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës prej 2,400,000 lekë.

**7.1 Rekomandim:** Sektori i Taksave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Procedurave të Prokurimit Publik dhe Sektorin e Zhvillimit Urban dhe Kadastrës, të bashkërendojnë punën për evidentimin e subjekteve fizik/juridik që nuk janë të regjistruara në regjistrin tregtarë të kësaj njësie vendore, për pajisjen me Nipt sekondar dhe maturimin e detyrimeve për taksa e tarifa vendore. Sektori i Taksave Vendore Bashkia Memaliaj, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit të pamaturuar në vlerën 180,000 lekë ndaj 5 subjekteve.

**9.1 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Memaliaj të marrë masat e nevojshme, si dhe vlerësimin e mundësisë për përfshirjen e taksave dhe tarifave vendore që aplikohen në NJA-ve, në faturën e ujit të pijshëm, duke përdorur si agjent tatimor “UK Memaliaj” Sha, për arkëtimin e tyre.

**9.2 Rekomandim:** Sektori i Taksave Vendore të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë nga taksat familjare prej 6,680,975 lekë.

**9.3 Rekomandim:** Sektori i Taksave Vendore të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë nga agjenti tatimor “UK Memaliaj” Sha, prej 1,125,309 lekë.

**10.1 Rekomandim:** Sektori Taksave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e NJA-ve dhe Sektorin e Bujqësisë, të marrë masa për evidentimin e të gjithë familjeve me tokë bujqësore dhe të pataksuar, me qëllim planifikimin e saktë të të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore.

**11.1 Rekomandim:** Sektori i Taksave Vendore Bashkia Memaliaj të marrë masa dhe të ndjek të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë prej 6,731,799 lekë nga taksa e tokës bujqësore.

**D. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efencë dhe efektivitet të fondeve publike.**

**1.1 Rekomandim:** AK në hartimin e DT, të shmang aplikimin e kriterëve që nuk janë përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës, në mënyrë jo të mirë argumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, pasi këto veprime direkt ose indirekt pengojnë pjesëmarrjen e OE në procedurë ose çojnë në skualifikimin e OE me ofertë më të leverdishme. Gjithashtu, Titullari i Bashkisë Memaliaj dhe KVO, të marrin masa për eliminimin e rasteve të mësipërme, duke analizuar arsyet e skualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë, të cilët plotësojnë kriteret e DT, në mënyrë që në të ardhmen të mos përsëriten veprime të tilla, për të mirë përdorur fondet e Bashkisë.

**2.1 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Memaliaj, nëpërmjet Sektorit të Zhvillimit Urban dhe Kadastrës, të marrë masa që në të ardhmen, të aplikojë dhe të miratojë lejet e ndërtimit, në zbatim të përcaktimeve ligjore për kryerjen e punimeve të ndërtimit.

Të kërkohet nga mbikëqyrësit e punimeve të ndërtimit, kontrolli i mbarëvajtjes të të gjithë procesit të zbatimit të punimeve, në përputhje me projektin, në mënyrë që të mos ndryshojnë në thelb kushtet kryesore të projektit, të përmirësohen treguesit e veprës, duke i bërë ato sa më eficente, për t'i shërbyer komunitetit në kohë.

**Statusi i rekomandimit: I pranuar.**

**Koment i grupit të auditimit:** Referuar përgjigjeve të paraqitura nga Bashkia Memaliaj në zbatim të pyetësorit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

**Rekomandimi nuk është zbatuar**

**B. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA**

**1.1.Rekomandimi:** Sektori Taksave Vendore bashkia Memaliaj të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë nga taksat dhe tarifatat për biznese, institucione dhe familjare prej **20,273 mijë lekë**.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Statusi i rekomandimit: I pranuar.**

**Koment i grupit të auditimit:** Në lidhje me marrjen e masa për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura si pasojë e mos likuidimit të taksave dhe tarifave vendore nga subjektet biznesi i madh dhe i vogël për vitet 2023-2024, Bashkia Memaliaj ka hartuar shkresën tip me nr. 1464 prot., datë 28.06.2024, për biznesin e vogël dhe shkresën nr. 2017 prot., datë 20.09.2024, për biznesin e madh, me objekt "Njoftim për pagesën e detyrimeve për vitet 2023-2024".

**Rekomandimi është në proces zbatimi**

**C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH**

**1.1. Rekomandimi:** Sektori Taksave Vendore bashkia Memaliaj të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe gjyqësore për arkëtimin e vlerës debitorë prej **2,525 mijë lekë** të cilat përbëjnë të ardhura të munguara për Bashkinë Memaliaj.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**Statusi i rekomandimit: I pranuar.**

**Koment i grupit të auditimit:** Referuar përgjegjeve të paraqitura nga Bashkia Memaliaj në zbatim të pyetësorit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.  
**Rekomandimi nuk është zbatuar**

#### D. MASA DISIPLINORE

Për të gjithë punonjësit trajtuar me përgjegjësi në Raportin Përfundimtar të Auditimit, nga KLSH-ja nuk është rekomanduar dhënia e masës disiplinore konkrete, pasi shkeljet e konstatuara dhe të evidentuara janë nën materialitetin e përcaktuar nga grupi i auditimit, **lihet në kompetencë të Kryetarit të Bashkisë Memaliaj**, fillimin ose jo të procedurave disiplinore në referim të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, VKM nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil” dhe shkronja “e” dhe “ç” të nenit 11, kreun IV, dhe nenin 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bazuar në kontratën individuale të punës.

**Statusi i rekomandimit: I pranuar.**

**Koment i grupit të auditimit:** Referuar përgjegjeve të paraqitura nga Bashkia Memaliaj në zbatim të pyetësorit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.  
**Rekomandimi nuk është zbatuar**

### IV. REKOMANDIME

#### A. MASA ORGANIZATIVE

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi lidhur me menaxhimin financiar dhe kontrollin u konstatua se Bashkia Memaliaj:

Nuk ka ngritur një sistem efektiv për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim. Nuk ka hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit. Nuk ka kryer procesin e vlerësimit të punonjësve për periudhën në auditim. Në procedurat e marrjes në punë të punonjësve, marrëdhëniet e punës të cilëve rregullohen me kodin e punës, u konstatua se nuk janë hartuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen e tyre në punë. Nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, pra nuk është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, vlerësimi, për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave. Nuk ka hartuar listën e proceseve/manualeve e procedurave të punës. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve dhe ankesave, për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 20, neni 8, gërma “a”, neni 16, pikat 2-3, neni 21, pika 2 dhe Manualin për MFK-në i miratuar me Urdhrin e MFE-së nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III, pika 3.1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 14-22 të Raportit të Auditimit).

**1.1 Rekomandimi:** Strukturat përgjegjëse, të marrin masa për plotësimin e mangësive të evidentuara si dhe implementimin e një sistemi të përshtatshëm rregullash të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, konform përcaktimeve të ligjit të MFK-së dhe aktet në zbatim të tij, për ta bërë atë efektiv dhe në dobi të veprimtarisë institucionale.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” paraqitet më datë 01.01.2024, në vlerën 52,437,297 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 68,510,006 lekë. Kjo llogari nuk kuadron me mbylljen e shumatores së llogarisë 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në vlerën 68,510,006 lekë dhe llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” në vlerën 26,094,899 lekë. Llogaria “Disponibilitete në thesar” është nënvlerësuar në vlerën 26,094,899 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pikat 49-50. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-45 të Raportit të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës të marrë masa që në pasqyrat financiare të vitit 2025 të kryejë kontabilizimin e saktë të llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” me qëllim dhënien e informacionit kontabël të saktë.

*Deri më datë 31.03.2026*

**3. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 532 “Vlera të tjera” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 14,528,983 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 26,094,899 lekë me një rritje në vlerën 11,565,916 lekë. Në gjendjen e llogarisë 532 “Vlera të tjera” është përfshirë vlera prej 26,094,899 lekë që i përket 5% të garancive të punimeve si veprim kundërpattie e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”. Ndërkohë që shumatorja e llogarive 85 “Rezultati i veprimtarisë ushtrimore” dhe 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” duhet të kuadrojë me mbylljen e gjendjes së llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar”. Në llogarinë 532 “Vlera të tjera” kontabilizohen mjetet që ruhen në arkë në formën e pullave tatimore, pullave postare, bileta apo vlerave të tjera. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pikat 3.2-3.3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-45 të Raportit të Auditimit).

**3.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e vlerës 26,094,899 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar të 5% të garancive të punimeve në llogarinë 532 “Vlera të tjera”, duke i kontabilizuar në llogarinë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”.

*Deri më datë 31.03.2026*

**4. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llogarisë 411 “Klientë e llogari të ngjashme” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 39,991,494 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 48,437,125 lekë me një rritje në vlerën 8,445,631 lekë. Në gjendjen e llogarisë 411 “Klientë e llogari të ngjashme” është kontabilizuar vlera 48,437,125 lekë që i përket debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore dhe përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, vlerë e cila duhej të kontabilizohet në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”. Referuar trajtimit kontabël në llogarinë 411 “Klientë e llogari të ngjashme” kontabilizohen të ardhura nga mallrat apo shërbimi me arkëtim të mëvonshëm. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 4.2, pika 5, dhe Kapitulli II, Seksioni 2.2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-45 të Raportit të Auditimit).

**4.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e vlerës 48,437,125 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar të debitorëve nga taksat dhe tarifat vendore në llogarinë

411 “Klientë e llogari të ngjajshme”, duke i kontabilizuar në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”.

*Deri më datë 31.03.2026*

**5. Gjejte nga auditimi:** a. Në llogaritë 423,429 “Personeli, paradhënie, defiçite, gjoba”, 431 “Tatim e taksa” dhe 436 “Sigurime shëndetësore” është kontabilizuar vlera totale prej 14,054,567 lekë në Aktiv, si kundërparti e Pasivit për detyrimet të cilat i përkasin muajit dhjetor të vitit ushtrimor që likuidohen në muaj janar të vitit pasardhës, ndërkohë që si veprim kontabël duhej të kryej në llogarinë 4342 “Operacion me shtetin (të drejta)”.

b. Në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, përmbledhsja e llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” paraqitet në vlerën 48,437,125 lekë, 42 “Detyrime ndaj personelit” në vlerën 11,181,933 lekë, 431 “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” në vlerën 900,979 lekë, 435 “Sigurime shoqërore” në vlerën 1,971,655 lekë, 464 “Detyrime për tu paguar për blerjen e letrave me vlerë” në vlerën 357,603 lekë dhe 467 “Kreditorë të ndryshëm” në vlerën 11,514,715 lekë ku totali shkon në vlerën 74,364,010 lekë e cila nuk kuadron me llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (Të drejta)” në vlerën 944,650 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-45 të Raportit të Auditimit).

**5.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në Bashkinë Memaliaj në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2025 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël të pranuar, që për vlerat e detyrimeve afatshkurtra në lidhje me pagat, tatimin mbi të ardhurat, kontributet shoqërore e shëndetësore të muajit dhjetor të vitit ushtrimor, të paraqitura gabimisht në llogaritë e arkëtueshme analoge në aktiv të bilancit, ti kontabilizojë në mënyrë të saktë në gjendjen e llogarisë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” dhe në rakordim me gjendjen në llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”, në Formatin e Performancës së PF.

*Deri më datë 31.03.2026*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” më datë 31.12.2024, është paraqitur në vlerën 11,514,715 lekë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Seksioni 3.1, pika 15, për arsye se kjo vlerë duhej të kontabilizohej në llogarinë 467 “Kreditorë të ndryshëm”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-45 të Raportit të Auditimit).

**6.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës të marrë masat e nevojshme për mbylljen e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” e cila është llogari rregulluese dhe nuk është pjesë e pasqyrës së pozicionit financiar. Detyrimet e prapambetura duhet të regjistrohen në debi të llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” dhe në kredi të llogarive 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, 467 “Kreditorë të ndryshëm”.

*Deri më datë 31.03.2026*

**7. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 202 “Studime dhe kërkime” më datë 01.01.2024, ka qenë në vlerën 3,945,960 lekë. Gjatë vitit 2024 për këtë llogari ka pasur shtesa në vlerën 2,070,440 lekë dhe pakësime në vlerën 2,070,440 lekë ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie

paraqitet në vlerën 3,945,960 lekë. Vlera e mbetur në fund të vitit 2024, prej 3,911,473 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime*”, për 20 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75, dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, Kreu II, Aneksi 1, pika 2, klasa 2, dhe pika 5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-45 të Raportit të Auditimit).

**7.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e llogarisë 202 “*Studime dhe kërkime*”, duke bërë që kjo llogari të pakësohet me vlerën 3,911,473 lekë dhe kjo vlerë të shtohet në vlerën e investimeve të përfunduara.

*Deri më datë 31.03.2026*

**8. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se, më datë 31.12.2024, llogaritë 210 “*Toka, troje, terrene*” të pasqyruara në bilanc për vlerën 119,998 lekë dhe 211 “*Pyje, kullota, plantacione*” në vlerën 277,000 lekë janë të paanalizuara, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave për këto llogari. Këto veprime janë në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “*Aktivet materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale*”, Kapitulli “*Trajtimi Kontabël për Aktivet Afatgjata të Investuara*”, pikat 47-54, dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “*Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*” i ndryshuar, pikat 26-30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-45 të Raportit të Auditimit).

**8.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Memaliaj të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llogaritë 210 “*Toka, troje, terrene*” dhe 211 “*Pyje, kullota, plantacione*” dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të kryejë zbrërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

*Deri më datë 31.03.2026*

**9. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 215 “*Mjete transporti*” më datë 31.12.2024, paraqitet në vlerën 1,314,529 lekë. Në gjendjen e kësaj llogarie është kontabilizuar vlera prej 3,312,750 lekë kosto historike që i përket automjeteve të dëmtuara të cilat nuk janë në gjendje pune, të konstatuara si të tilla në procesin e inventarizimit. Në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, Aneksi nr. 1, pika 2.1, vlera 3,312,750 lekë e cila i përket kosto historike mjete të dëmtuara duhej të debitohej në llogarinë 24 “*Aktive afatgjata të dëmtuara*”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-45 të Raportit të Auditimit).

**9.1. Rekomandimi:** Bashkia Memaliaj, Drejtoria e Financës në pasqyrat financiare të vitit 2025 të bëjë sistemimin e vlerës 3,312,750 lekë kosto historike e cila ka të bëjë me kontabilizimin dhe

paraqitjen e gabuar të aktiveve të dëmtuara që i përkasin llogarisë 215 “Mjete transporti”, sistemi të kryhet referuar trajtimit kontabël në llogarinë 24 “Aktive afatgjata të dëmtuara”.

*Deri më datë 31.03.2026*

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i Pasqyrës nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve” janë konstatuar parregullsitë e mëposhtme në përllogaritjen e normave të amortizimit për aktivet jo materiale dhe materiale konkretisht:

- Për llogarinë 202 “Studime dhe kërkime” për vitin 2024 nuk është përllogaritur normë amortizimi.

- Për llogarinë 218 “Inventar ekonomik” është përllogaritur normë amortizimi i akumuluar deri më datë 31.12.2024, në vlerën 40,931,901 lekë (kosto historike) ose në masën 20%. Ndërkohë që nuk ka një ndarje të llogarisë 218/6 “Pajisje kompjuterike” nga aktivet e llogarisë bazë 218 “Inventar ekonomik” e cila ka normë amortizimi të aplikueshme në masën 25%,

- Për llogarinë 215 “Mjete transporti” deri më datë 31.12.2023, është përllogaritur amortizim i akumuluar në vlerën 12,179,821 lekë por nuk është përllogaritur amortizim vjetor.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 36. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-45 të Raportit të Auditimit).

**10.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës të marrë masa për aplikimin e normës së amortizimit për llogaritë 202 “Studime dhe kërkime”, 215 “Mjete transporti” dhe 218 “Inventar ekonomik” që nga momenti që aktivi ka filluar jetën e dobishme duke përmbushur njëkohësisht dispozitat ligjore përkatëse.

*Deri më datë 31.03.2026*

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta”, u konstatua se kjo llogari është nënvlerësuar në vlerën 322,000 lekë. Vlera e aksioneve të Shoqërisë Aksionare Ujësjiellës Kanalizime Memaliaj me Nipt M09831502C është 159,000,000 lekë e cila është bërë pjesë e Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Gjirokastër me Nipt M23329601L. Vlera e aksioneve që ka në pronësi Bashkia Memaliaj është 322,000 ose 3.22% ( $3.22 \cdot 10,000,000 / 100 = 322,000$  lekë). Ndërkohë që llogaria 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” më datë 31.12.2023, paraqitet në vlerën 0 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5, “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale” i përmirësuar, pikat 55-57, Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14, “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”, pikat 27-30, dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-45 të Raportit të Auditimit).

**11.1. Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Financës të merren masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalet e veta” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrje në kapitalin e vet.

*Deri më datë 31.03.2026*

**12. Gjetje nga auditimi:** Gjendja e llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” në mbyllje të vitit ushtrimor 2024 paraqitet në vlerën 0 lekë, kur në fakt nga testimi i kontratave të investimeve konstatohet se, për vitin 2024 ka kontrata që nuk kanë përfunduar si punime dhe

likujdimi i tyre është për një hark kohor më shumë se një vit konkretisht, “Rikonstruksioni i shkarjeve të rrugëve të Njësisë Administrative Buz-Lutfinjë” në vlerën 20,675,896 lekë; “Skema ujitëse vaditëse “Kanali ujitës” Krahas” në vlerën 7,224,000 lekë; “Rikonstruksioni i Gjumnazit dhe ambienteve sportive “Sali Nivica” në vlerën 53,557,000 lekë; “Ndërtimi i Ujësjellësit Rajonal për fshatrat Vasjar, Iliras, Qësarat, Anë Vjosë, Toç, Lulëzim, Zhulaj, Krahas dhe Qytetin Memaliaj” në vlerën 179,028,083 lekë dhe “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e pafavorizuara, Bashkia Memaliaj” në vlerën 30,934,440 lekë. Vlera prej 291,419,419 lekë e kontratave të sipërpërmendura duhet të ishte pjesë e gjendjes së llogarisë 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT” dhe jo pjesë e gjendjes së llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore” siç ka ndodhur në fakt, pasi ky aktiv nuk është kapitalizuar në vlerë të plotë. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, Aneksi 1, Klasa 23. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-45 të Raportit të Auditimit).

**12.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në mbajtjen e kontabilitetit për blerje aktiveve afatgjata materiale dhe jo materiale, për pagesa të vlerave pjesore të AQT, duhet t’i evidentojë në llogaritë 230 - 231 “Shpenzime në proces për rritjen e AQT”, deri në vlerë të plotë dhe pas realizimit të investimit dhe likuidimit të plotë të vlerës së kontratave t’i kontabilizojë në llogaritë e klasave 20-21 sipas llojit të aktivitetit të kapitalizuar.

*Deri më datë 31.03.2026*

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se referuar inventaritet të aseteve, Bashkia Memaliaj zotëron në total 3,293 asete të transferuara me VKM, nga të cilat për 2,028 raste është miratuar lista përfundimtare, ndërkohë pjesa e mbetur janë në fazë paraprake. Deri më datë 31.12.2024, në total janë pajisur me çertifikatë pronësie 3 prona dhe 3 prona janë proces çertifikimi.

- Për aktivitet që i përkasin llogarisë 210 “Toka, troje, terrene”, llogarisë 211 “Pyje, kullota, plantacione”, llogarisë 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, Bashkia Memaliaj të cilat janë të evidentuara në kontabilitet vetëm 3 prej tyre janë të pajisura me çertifikatë pronësie. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35, gërma “a”, “b” dhe “c” për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur ligjor. Nga Bashkia Memaliaj nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura sipas llogarive 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, kullota, plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë” Kreu IV neni 37 pika 1, 2, gërmat “a-b”, Ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 35-41, VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-45 të Raportit të Auditimit).

**13.1. Rekomandimi:** Bashkia Memaliaj të marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithë aseteve të llogarive 210 “Toka, troje, terrene”, 211 “Pyje, kullota plantacione”, 212 “Ndërtesa e konstruksione” dhe 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” duke

përfshirë këtu edhe asetet e ish-komunave, sot Njësi Administrative të Bashkisë. Bazuar në legjislacionin në fuqi të bëhet vlerësimi i aseteve për vlerën e tyre reale, sipas zonave kadastrale. Të merren masa për regjistrimin e aseteve si pasuri e saj në ASHK.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**14. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” më datë 01.01.2024, është në vlerën 39,991,494 lekë në të cilën duhet të paraqiten faturat e pa likuiduara nga Bashkia Memaliaj. Gjatë vitit 2024 ka pasur shtesa në vlerën 18,086,204 lekë lekë dhe pakësime në vlerën 9,640,573 lekë, ndërsa më datë 31.12.2024, gjendja e kësaj llogarie paraqitet në vlerën 48,437,125 lekë. Në gjendjen e llogarisë 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*” është përfshirë vlera prej 48,437,125 lekë që i përket debitorëve nga taksat dhe tarifatat vendore të cilat duhej të kontabilizoheshin në llogarinë 468 “*Debitorë të ndryshëm*”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, pika 3.3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-45 të Raportit të Auditimit).

**14.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e vlerës 48,437,125 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar të debitorëve nga taksat dhe tarifatat vendore në llogarinë 401-408 “*Furnitorë e llogari të lidhura me to*”, duke i kontabilizuar në llogarinë 468 “*Debitorë të ndryshëm*”.

***Deri më datë 31.03.2026***

**15. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 435 “*Sigurime shoqërore*” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore për pagat e muajit dhjetor të vitit 2024 që paguhet në muajin janar të vitit pasardhës dhe janë përkatësisht në vlerat 1,971,655 lekë. Nga auditimi konstatohet se në gjendjen e llogarisë 435 “*Sigurime shoqërore*” janë kontabilizuar edhe detyrimet që i përkasim detyrimeve shëndetësore të muajit dhjetor që mbeten për t’u likuiduar në muajin janar të vitit pasardhës, ndërkohë që këto detyrime duhej të kontabilizoheshin në llogarinë 436 “*Sigurime shëndetësore*”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” i ndryshuar, pika 3.3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-45 të Raportit të Auditimit).

**15.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës të kryejë veprimet rregulluese në gjendjen e llogarisë 435 “*Sigurime shoqërore*”, duke kontabilizuar diferencën që i përket detyrimeve për sigurimet shëndetësore të cilat paguhet në muajin janar të vitit pasardhës në llogarinë 436 “*Sigurime shëndetësore*”.

***Deri më datë 31.03.2026***

**16. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 464 “*Detyrime për t’u paguar për blerjen e letrave me vlerë*” më datë 01.01.2024, paraqitet në vlerën 610,860 lekë ndërsa në mbyllje të bilancit më datë 31.12.2024, në vlerën 357,603 lekë me një pakësim në vlerën 253,257 lekë. Në gjendjen e llogarisë 464 “*Detyrime për t’u paguar për blerjen e letrave me vlerë*” është përfshirë vlera prej 357,603 lekë e cila i përket disponibilitetit të pullave postare dhe biletave të tregut të cilat duhet të kontabilizoheshin në llogarinë 50 “*Letra me vlerë*”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 09.03.2018, “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së*

*përgjithshme” i ndryshuar, pika 3. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-45 të Raportit të Auditimit).*

**16.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës të marrë masa për sistemimin e vlerës 357,603 lekë e cila ka të bëjë me kontabilizimin e gabuar të pullave postare dhe biletave të tregut në llogarinë 464 “Detyrime për t’u paguar për blerjen e letrave me vlerë”, duke i kontabilizuar në llogarinë 50 “Letra me vlerë”.

***Deri më datë 31.03.2026***

**17. Gjetje nga auditimi:** Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje” sipas pasqyrës së pozicion financiar të Bashkisë Memaliaj në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerë 26,094,899 lekë dhe përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masës 5%. Për 25 objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Memaliaj janë ngurtësuar fonde në vlerën 7,159,788 lekë për të cilat nuk është bërë zhbllokimi i tyre, pasi fondet gjenden të ngurtësuar në Degën e Thesarit Tepelenë, për të cilat është përmbushur afati i garancisë së punimeve sipas kushteve të kontratës. Nga Drejtoria e Financës nuk janë marrë masa për zhbllokimin e këtyre fondeve, nuk janë njoftuar subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të duhur për likuidimin e vlerës 7,159,788 lekë, ose përdorimin për interes publik të këtyre fondeve, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2011, “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kapitulli II, pika 10. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-45 të Raportit të Auditimit).

**17. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Memaliaj, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrin masa për analizimin e përdorimit për interes publik të fondeve që ju ka mbaruar periudha e garancisë, bazuar në kushtet e kontratës të lidhur me subjektet përkatëse dhe Autoriteti Kontraktor nuk ka pretendime për cilësinë e investimin të kryer për periudhën e garancisë.

***Deri më datë 31.12.2025***

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se buxheti fillestar i Bashkisë Memaliaj për vitin 2024 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak nr. 93, datë 27.12.2023, dhe është konfirmuar në përputhje me kërkesat ligjore nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë. Totali i të ardhurave të planifikuara ishte 319,174 mijë lekë, ndërsa totali i shpenzimeve të planifikuara kapte vlerën 328,779 mijë lekë. Gjatë vitit 2024 janë kryer ndryshime në buxhet përmes akteve shtesë dhe rishpërndarjeve të fondeve, përfshirë fonde të trashëguara nga viti 2023, shtesa për paga dhe sigurime në funksion të ndryshimeve në pagën minimale, si dhe fonde për investime dhe shlyerje të detyrimeve të prapambetura. Megjithatë, këto ndryshime nuk janë të strukturuar në një pasqyrë të përmbledhur që të dokumentojë efektet e tyre në planifikimin fillestar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-45 të Raportit të Auditimit).

**18.1. Rekomandim:** Bashkia Memaliaj të hartojë dhe të mbajë një përmbledhje të detajuar të të gjitha ndryshimeve buxhetore të miratuara gjatë vitit, të shoqëruara me VKB-të përkatëse dhe me analiza të ndikimit financiar. Kjo do të ndihmonte në forcimin e transparencës, gjurmueshmërisë dhe përgjegjshmërisë në menaxhimin e buxhetit publik.

***Menjëherë dhe në vijimësi***

**19. Gjetje nga auditimi:** Sipas të dhënave të siguruar nga drejtoria e financës, për vitin 2024 ishte parashikuar një total shpenzimesh prej 760,976 mijë lekësh, ndërsa shpenzimet faktike të

realizuara rezultojnë në vlerën 629,007 mijë lekë. Kjo përkthehet në një përqindje realizimi prej 82.6%. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-45 të Raportit të Auditimit).*

Megjithatë, në analizën e detajuar të zërave buxhetorë, vihet re se disa prej tyre janë realizuar në masë të tejkaluar, ndërsa të tjerë mbeten shumë poshtë planit. Kjo luhatje tregon për mospërputhje ndërmjet planifikimit dhe ekzekutimit buxhetor, si dhe për mungesë të mekanizmave të kontrollit të brendshëm në monitorimin të buxhetit gjatë vitit.

**19.1. Rekomandim:** Bashkia Memaliaj të zhvillojë analiza periodike mbi realizimin e buxhetit dhe të marrë masa korigjuese për të shmangur devijimet. Po ashtu, përdorimi i raporteve të monitorimit duhet të kalojë nga formalitet në një mjet real menaxherial për drejtimin e financave publike.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**20. Gjetje nga auditimi:** Në fund të vitit 2024, Bashkia Memaliaj rezulton me një nivel të konsiderueshëm të detyrimeve të prapambetura, të cilat arrijnë në totalin 11,514,715 lekë. Kjo përfshin detyrime ndaj OSHE për konsum të energjisë elektrike dhe kamatëvonesa, si dhe ndaj operatorëve ekonomikë për shërbime të ndryshme dhe investime.

Gjithashtu, vihet re prania e detyrimeve të papaguara nga vendime gjyqësore të formës së prerë, të cilat përbëjnë një rrezik të drejtpërdrejtë ligjor dhe financiar për institucionin, duke rritur mundësinë për penalitete, bllokim llogarish apo rritje të borxheve.

Ky nivel detyrimesh reflekton një dobësi të theksuar në menaxhimin financiar të angazhimeve, duke treguar se shpesh janë ndërmarrë shpenzime pa siguruar më parë burimet e nevojshme të financimit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-45 të Raportit të Auditimit).*

**20.1. Rekomandim:** Bashkia Memaliaj të hartojë një plan konkret për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura, të krijojë një regjistër të përditësuar elektronik të tyre, si dhe të ndërlihdë procesin e prokurimit me kufijtë e buxhetit të miratuar.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**21. Gjetje nga auditimi:** Për vitin 2024, në buxhetin e Bashkisë Memaliaj ishin planifikuar 326,864 mijë lekë për investime, nga të cilat janë realizuar në fakt 246,173 mijë lekë, duke përfaqësuar një realizim prej 75%. Edhe pse kjo është një normë mesatarisht e pranueshme, duhet theksuar se disa nga projektet më të rëndësishme infrastrukturore dhe të mirëfunksionimit të administratës nuk janë zbatuar, përfshirë rikonstruksione rrugësh, pajisje kompjuterike dhe automjete. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-45 të Raportit të Auditimit).*

Arsyet kryesore lidhen me vonesa në procedurat e prokurimit publik, vështirësi në çeljen e fondeve dhe probleme me zbatimin teknik. Ky nivel i ulët i realizimit përbën një dëm të drejtpërdrejtë në ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe në efektivitetin e përdorimit të fondeve publike.

**21.1. Rekomandim:** Bashkia Memaliaj të përgatisë një kalendar të detajuar për realizimin e investimeve, të forcojë bashkëpunimin ndërmjet sektorëve të financës dhe prokurimeve, si dhe të kryejë analizë pas veprimit për çdo projekt të përcaktuar shkaqet dhe përgjegjësit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**22. Gjetje nga auditimi:** Gjatë vitit 2024, Bashkia Memaliaj kishte planifikuar të ardhura vendore në shumën 31,345 mijë lekë, ndërsa të ardhurat faktike të realizuara ishin 28,626 mijë lekë, që përbën një realizim prej 91.3%.

Megjithëse në terma totale performanca është pozitive, një analizë më e thelluar tregon probleme serioze në disa kategori specifike të taksave dhe tarifave. Të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë janë realizuar vetëm 28%, ndërsa realizimi i taksave mbi ndërtesën, truallin dhe qiratë mbetet nën 30%. Këto tregojnë për mangësi të theksuara në mbledhjen, ndjekjen dhe administrimin e taksave vendore. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 23-45 të Raportit të Auditimit).*

**22.1. Rekomandim:** Bashkia Memaliaj të hartojë një strategji të qartë për përmirësimin e performancës fiskale, të forcojë kapacitetet administrative të sektorit të tatim-taksave, dhe të zbatojë masa konkrete për rritjen e arkëtimeve, duke përfshirë përdorimin e teknologjisë për ndjekjen e debitorëve dhe formalizimin e tatimpaguesve.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**23. Gjetje nga auditimi:** Raportit Përfundimtar të Auditimit për auditimin e ushtruar në Bashkinë Memaliaj administruar në KLSH me nr. 494/8 prot., datë 03.07.2024, dhe protokolluar në Bashkinë Memaliaj me nr. 1500 prot., datë 05.07.2024, ku janë lënë për zbatim **16 masa** organizative, **1 masë** për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore përfshirë edhe detyrimet nga qiradhënie në vlerën **20,273,000 lekë**, **1 masë** për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, me efekt mungesë të ardhurash në vlerën **2,525,000 lekë** dhe **1 masë** disiplinore.

**a.** Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 16 masa organizative të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 2 masa janë zbatuar plotësisht, 4 masa janë zbatuar pjesërisht, 3 masa janë në proces zbatimi dhe 7 masë nuk është zbatuar.

**b.** Për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia është rekomanduar 1 masë në vlerën 20,273,000 lekë e cila është pranuar plotësisht dhe është në proces zbatimi.

**c.** Për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, me efekt mungesë të ardhurash është rekomanduar 1 masë në vlerën 2,525,000 lekë e cila është pranuar plotësisht dhe është nuk është zbatuar.

**d.** Masa disiplinore është rekomanduar 1 masë e cila është pranuar plotësisht dhe është e pa zbatuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 45-54 të Raportit të Auditimit).*

**23.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Memaliaj të analizojë situatën e zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës, si dhe të hartojë plan pune të veçantë e të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për zbatimin e rekomandimeve të pa zbatuara, të zbatuara pjesërisht dhe përsheptimin e rekomandimeve në proces zbatimi si më poshtë:

**a.** Për 4 masa organizative të zbatuar pjesërisht, 3 masa në proces zbatimi dhe 7 masa të pa zbatuar: nr. 1.1, 3.1, 4.1, 5.1, 6.1, 7.1, 8.1, 9.1, 10.1, 11.1, 12.1, 13.1, 15.1 dhe 16.1;

**b.** Për 1 masë për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia, në proces zbatimi: nr. 1.1;

**c.** Për 1 masë për eliminimin e efekteve negative në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore, me efekt mungesë të ardhurash, e pa zbatuar: nr. 1.1.

**d.** Për 1 masë disiplinore e pa zbatuar: nr. 1.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

Për sa më sipër paraqitet ky Raport Auditimi.

**KONTROLI I LARTË I SHTETIT**